



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



KONEKT



European Center for
Not-for-Profit Law

DORACAK PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE



MBRONI ORGANIZATËN TUAJ

Parandalimi i ekspozimit të sektorit
jofitimprurës ndaj pastrimit të parave
dhe financimit të terrorizmit



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



KONEKT



European Center for
Not-for-Profit Law

DORACAK PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE

MBRONI ORGANIZATËN TUAJ

Parandalimi i ekspozimit të sektorit jofitimprurës ndaj
pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Shkup, 2021

Botues: Shoqata Konekt

Autorë: Nikica Kusinikova

Viktor Mirçevski

Katerina Haxhi Miceva Evans

Vanja Skoriq

mr. Iskra Damçevska

dr. Ivica Simonovski

Bashkëpunëtorë profesionistë: Benxhamin Evans, Dijana Rikallovska

Përktheu dhe lektoroi: Lingua Shkup

Disenjoi dhe botoi: Koma Shkup

Ky publikim është hartuar nga Shoqata Konekt, Qendra Evropiane për të Drejtën Jofitimprurëse dhe Zyra e Inteligjencës Financiare e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mbështetje e popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Të drejtat autoriale ©2021 nga Konekt

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

343.9.024:061.23(035)

343.341:336.7]:061.23(035)

PARANDALIMI i ekspozimit të sektorit jofitimprurës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit : doracak për organizatat jofitimprurëse : mbron organizatën tuaj / [autorë Nikica Kusinikova ... [и др.]. - Shkup : Konekt, 2021. - [114] стр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Превод на делото: Prevention of the exposure of the non-profit sector to money laundering and financing of terrorism : handbook for non-profit organizations : protect your organization / Nikica Kusinikova ... [и др.]. - Други автори: Viktor Mirčevski, Katerina Haxhi Miceva Evans, Vanja Skoriq, Iskra Damčevska, Ivica Simonovski. - Библиографија: стр. 54-57. - Содржи и: Aneks I-III

ISBN 978-608-4835-11-0

1. Kusinikova, Nikica [автор] 2. Mirčevski, Viktor [автор] 3. Hadji Miceva Evans, Katerina [автор] 4. Skoriq, Vanja [автор] 5. Damčevska, Iskra [автор] 6. Simonovski, Ivica [автор]

а) Непрофитни организации -- Перење пари -- Заштита -- Прирачници б) Непрофитни организации -- Финасирање тероризам -- Заштита -- Прирачници

COBISS.MK-ID 55914501

6 PËR DORACAKUN

8 NË PIKA TË SHKURTRA – RËNDISA PËR ORGANIZATËN TIME

10 I. LISTA E SHKURTESAVE

11 II. DEFINIMI DHE SHPJEGIMI I TERMINOLOGJISË

18 III. HYRJE NË SISTEMIN PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT

19 Rëndësia e organizatave jofitimprurëse

20 Korniza për PFT dhe PPP në Maqedoninë e Veriut

22 | Pronësi e vërtetë

25 | Drejtoria për Zbulim Financiar

26 | Organe të tjera kompetente

27 | Përshkrimi i punës bankare

32 Rregullativa ndërkombëtare

32 | Standarde globale për PPP/PFT të cilat janë relevante për sektorin jofitimprurës

38 | Korniza e standardeve të BE-së për PPP

40 Angazhimi i FATF në sektorin e OJF-ve

46 IV. QASJE E BAZUAR NË RREZIK DHE RELEVANCA E SAJ PËR OJF-NË TUAJ

46 | Mënyrat në të cilat OJF-të mund të keqpërdoren për qëllimet e FT

53 | Përshkrim i Vlerësimit të rrezikut nga FT për OJF-të në Maqedoninë e Veriut

65 | Çfarë do të thotë kjo për organizatën time

69 V. MBRONI ORGANIZATËN TUAJ

70 **HAPA 1** Identifikoni dhe kuptoni rreziqet
potenciale për ju

75 **HAPA 2** Bëni vlerësimin e rreziqeve

80 **HAPA 3** Definoni masat zbutëse

85 | Menaxhim i mirë demokratik

88 | Mësoni parimet tuaja – kontroll paraprak

91 | Njoftoni donatorin tuaj

95 | Njoftojeni shfrytëzuesin apo klientin tuaj

98 | Njoftojeni shfrytëzuesin/klientin tuaj

102 | Menaxhimi financiar

104 | Menaxhimi me resurset njerëzore

106 | Transparencë dhe llogaridhënie

108 | Vetërregullimi

109 **HAPA 4** Siguroni zbatim të vazhdueshëm

110 **HAPA 5** Bëni shqyrtime periodike dhe përshtatuni

111 **VI. ANEKSE**

111 Aneksi 1

113 The Procesi i vlerësimit të ndërsjellë

116 Aneksi 2

116 Angazhimi i FATF me sektorin e OJF-së


122 Aneksi 3

122 Angazhimi në procesin e vlerësimit të
rrezikut: Shembuj për praktika të mira:

125 **VIII. UDHËZIME**

PËR DORACAKUN

Qëllimi i doracakut është të sigurojë informacione të qarta dhe të kuptueshme për sektorin jofitimprurës lidhur me sistemin e mbrojtjes nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe mënyrën në të cilën ai është i lidhur me sektorin jofitimprurës.




Doracaku synon që t'u ndihmojë Organizatave Jofitimprurëse (OJF) ta rrisin vetëdijen për ekspozimin potencial ndaj rreziqeve në këtë sferë dhe të përfshijnë masat parandaluese dhe lehtësimin në punën e tyre. Fokusi i veçantë në këtë publikim i është kushtuar demonstrimit dhe përdorimit të qasjes së bazuar në rrezik që Maqedonia e Veriut e zbaton në zhvillimin e masave për zbutje në sferën e parandalimit të keqpërdorimeve për qëllimet e terrorizmit lidhur me sektorin e OJF-ve.

Edhe krahas asaj që në disa kapituj të këtij publikimi bëhet përqendrim në kontekstin e Maqedonisë së Veriut, ky doracak mund të përdoret edhe nga organizatat jofitimprurëse në mbarë botën, si edhe nga aturitetet të cilat dëshirojnë ta përmirësojnë komunikimin e tyre me sektorin e OJF në vendet e tyre respektive.

Ky doracak është përgatitur me angazhim të përbashkët të autorëve të Drejtorisë për Zbulim Financiar të Maqedonisë së Veriut, Qendrës Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (ECNL), Shoqatës Konekt dhe ekspertëve të cilët e dhanë kontributin e tyre në proceset e zbatimit të suksesshëm të standardeve ndërkombëtare si edhe në krijimin e praktikave të mira për parandalim dhe mbrojtje të sektorit QJF dhe sektorit qytetar prej keqpërdorimit të qëllimeve për financimin e terrorizmit. Ky doracak u mundësua nga Projekti i USAID-it për pjesëmarrje qytetare edhe nga ECNL.

Ky material është edukativ dhe qëllimi është ai të përdoret për ndërtimin e kapaciteteve të të gjithë profesionistëve, aktivistëve dhe vullnetarëve në organizatat jofitimprurëse. Megjithatë, ky doracak është doracak praktik për institucionet, bankat dhe të gjitha palët e tjera të involvuara të cilat kanë interaksion me sektorin e QJF. Nëse dëshironi më shumë njohuri për këtë çështje, ju lutem kontaktoni me Konekt në **konekt@konekt.org.mk** ose në **+389 (0)2/3224 198**.



NË PIKA TË SHKURTRA –

RËNDISA PËR ORGANIZATËN TIME

Është e rëndësishme çdo Organizatë jofitimprurëse (OJF) ta kuptojë se si standardet ndërkombëtare, legjislative nacionale lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit (PPP/PFT) dhe vlerësimi i rrezikut nga financimi i terrorizmit për OJF ndikojnë në aktivitetet e saja ligjore. Kjo do ta lehtësojë komunikimin dhe punën e organizatës tuaj me institucionet, bankat dhe partnerët në mënyrë e cila do të ndërtojë besim dhe do ta mbrojë organizatën dhe personat e përfshirë në të.

Shumica e organizatave jofitimprurëse në Maqedoninë e Veriut nuk janë të vetëdijshme për relevancën e rregullativave në këtë sferë lidhur me misionet dhe punën e tyre. Për këtë, ato shpesh nuk e kuptojnë arsyen për kërkesat ligjore dhe administrative të cilat pritët t'i përmbushin, ndërsa të cilat i përjetojnë si barë të panevojshme dhe nuk kuptojnë mjaftueshëm punën e tyre. Nga ana tjetër, nisur nga misioni dhe përkushtimi i tyre, OJF rrallë mendojnë për mundësinë që organizata e tyre të keqpërdoret për transaksione financiare të paligjshme. Që të mbrohet integriteti i organizatës, çdo organizatë e kujdesshme do të pranonte qasjen e bazuar në rrezik. Kjo do të thotë se organizata do të bëjë përpjekje për t'i kuptuar rreziqet përkatëse me të ciat mund të përballen OJF dhe do të miratoi masa për zbutjen e rreziqeve.

Ky doracak do t'u ndihmojë OJF-ve që të lëvizin nëpër rregullativë për PPP/PFT dhe të kuptojnë se si është e lidhur ajor dhe si ndikon mbi organizatën e tyre. Kapitulli V përmban udhëzime në të cilin janë përfshirë të gjitha hapat të cilat do t'i ndihmojnë organizatës tuaj në:

-
- Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat mund të përballen organizata juaj lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Mund ta përdorni veglën për vlerësimin e rrezikut për të kryer vlerësimin e rreziqeve të përgjithshme në organizatën tuaj dhe në këtë mënyrë të siguroni mbështetje për planifikimin tuaj strategjik dhe rezistencën e organizatës
 - Mbrojtja e organizatës nga keqpërdorimi potencial përmes integritetit të masave të arsyeshme dhe praktike për zvogëlimin dhe zbutjen e rreziqeve më të larta. Shembujt do t'ju ndihmojnë më lehtë të lëvizni përmes praktikave të OJF-ve, ndërsa secila prej pjesëve ofron edhe lista për verifikim dhe përmbledhje të masave të cilat mund t'i miratoni.
 - Përforcimi i integritetit të përgjithshëm të organizatës tuaj pasi një numër i madh i masave të përgjithshme për zbutje janë tërësisht të harmonizuara me praktikatat më të mira të OJF, siç janë menaxhimi i mirë, menaxhimi i përgjegjshëm financiar, angazhimi i besueshëm me faktorët kryesorë, transparencë, llogaridhënia dhe respektimi i mekanizmave për vetërregullim, siç janë kodet etike etj.

I.

LISTA E SHKURTESAVE

PPP	Parandalimi i pastrimit të parave
OQ	Organizatë/a qytetare
PFT	Parandalimi i financimit të terrorizmit
ECNL	Qendra evropiane për të drejtë jofitimprurëse
BE	Bashkimi Evropian
FATF	Grupi punues për aksion financiar
DZF	Drejtoria për Zbulim Financiar
PP	Pastrimi i parave
OJF	Organizatë/a Jofitimprurëse
VR	Vlerësimi i Rrezikut
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
RTD	Raport për Transaksione të Dyshimta
FT	Financimi i Terrorizmit

II.

DEFINIMI DHE SHPJEGIMI I TERMINOLOGJISË

Definimet vijuese që i përmbajnë **Rekomandimet e Grupit të Punës për Aksion Financiar (FATF)**, **Fjalor nga Rekomandimet e FATF** dhe burime të tjera.

OJF ekspresive

Përdoret nga Grupi i punës për aksion financiar (FATF) që të shënojë organizata jofitimprurëse që fillimisht janë të involvuara në funksione ekspresive – siç janë përfaqësimi, të shprehurit kulturologjik, organizimi në kuadër të bashkësisë, mbrojtja e mjedisit jetësor, të drejtat e njeriut, religjioni, përfaqësimi i interesave dhe të shprehurit politik¹ (siç janë partitë politike, organizatat think-tank dhe grupet e përfaqësimit).

Sipas FATF, OJF-të që janë të ekspozuara në rrezikun më të madh nga keqpërdorimi për financimin e terrorizmit janë të angazhuara në “aktivitetet shërbyese”

Asnjë nga OJF në studimet e rastit për keqpërdorimin e OJF për FT, të analizuara nga FATF, nuk është marrë me “aktivitete ekspresive”.

1 Shoqëri globale qytetare, Shqyrtim Lester M. Salamon, S. Vojceh Sokollovski, Rexhina list viti 2003., http://ccss.jhu.edu/wp-content/uploads/downloads/2011/09/Book_GCSOverview_2003.pdf

OJF me veprimtari shërbyese

OJF të cilat janë përfshirë në “funksione shërbyese”, siç janë sigurimi i shërbimeve shëndetësore, arsimore apo sociale.²

Kjo është në pajtim me përkufizimin e FATF për organizatat jofitimprurëse (shiko më poshtë).

Pastrimi i parave

Qëllimi i një numri të madh të veprave kriminale është të gjenerohet përfitimi për individin ose grupin që e kryen veprën. Pastrimi i parave është procesim i këtyre të ardhurave nga vepra ndësh të mbulohet origjina e tyre e paligjshme. Ky proces është me rëndësi kryesore, pasi i mundëson kriminelit që t'i përdorë këto të ardhura pa e komprometuar burimin e tyre.

Pastrimi i parave në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) është definuar në nenin 273 të Kodit Penal siç vijon: Ai që do të lëshojë në qarkullim, që do të marrë, ndërmarrë, zëvendësojë ose prishë para ose pronë tjetër që e ka përfituar nga një vepër penale ose për të cilën e di se është fituar nga një vepër penale, ose me shndërrim, ndryshim, transferim apo në ndonjë mënyrë tjetër e mbulon se vjen nga një burim i tillë ose që do ta fshehë vendndodhjen, lëvizjen ose pronësinë, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

2 Ibid.

Organizatat Jofitimprurëse

(përkufizimi i FATF)

Sipas përkufizimit të FATF, termi OJF ka të bëjë me një person juridik ose aranzhim ose organizatë e cila fillimisht merret me grumbullimin ose pagesën e mjeteve për qëllime bamirësie,

fetare, kulturore, arsimore, sociale ose vëllazërore, ose për kryerjen e llojeve të tjera të “veprave të mira” (siç përdoret ky term në shënimin Interpretativ ndaj Rekomandimit 8).

Në Maqedoninë e Veriut, sipas Vlerësimit të rrezikut nga financimi i terrorizmit për OJF, personat juridikë në vazhdim janë të përfshirë me përkufizimin e FATF për OJF:

- ➔ Shoqatat (pjesërisht)
- ➔ Organizata joqeveritare të huaja dhe ndërkombëtare
- ➔ Fondacione
- ➔ Kryqi i Kuq
- ➔ Kisha, bashkësi fetare dhe grupe religjioze

Terroristi

Termi terrorist ka të bëjë me çdo person fizik i cili: (i) kryen ose përpiket të kryejë akt terrorist në çfarëdo mënyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në mënyrë të paligjshme ose me vetëdije; (ii) merr pjesë si bashkëpjesëmarrës në një akt terrorist; (iii) organizon

ose i urdhëron të tjerët të kryejnë akte terroriste ose (iv) kontribuon drejt kryerjes së akteve terroriste nga një grup personash që vepron me një qëllim të përbashkët, me qëllim të realizimit të aktit terrorist ose me njohuritë për qëllimin që grupi të kryejë akt terrorist.

Nuk ekziston një përkufizim i dakorduar universal për terrorizmin, pasi koncepti për terrorin dallon në legjislativat e ndryshme.

Ekziston një rregull i thjeshtë në bashkësinë ndërkombëtare që e kërkon praninë e tre elementeve kryesore lidhur me veprën penale ndërkombëtare terrorizëm: (i) kryerja e veprës penale (si vrasja, rrëmbimi, marrja e pengjeve, zjarri dhe ngjashëm), ose kanosja për një akt të tillë; (ii) qëllimi që të përhapet frikë në mesin e popullatës (që në përgjithësi do të thotë krijim i rrezikut publik) ose detyrim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë të ndonjë organi kombëtar ose ndërkombëtar për të kryer ose për t'u përmbytur nga kryerja e disa veprimeve të caktuara; (iii) kur akti përfshin element transnacional.

Burimi: UNODC (Vendim i përkohshëm, 2011, paragrafi 85).

Akti terrorist

Akti terrorist përfshin:

A

Akt që paraqet vepër penale në kuadër të dhe siç është definuar në një prej marrëveshjeve vijuese: (i) Konventë për parandalimin e konfiskimit të paligjshëm të fluturakeve ajrore (1970); (ii) Konventë për shkatërrimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil (1971); (iii) Konventë për parandalimin dhe ndëshkimin e veprave penale kundër personave nën mbrojtjen ndërkombëtare, duke i përfshirë edhe agentët diplomatikë (1973); (iv) Konventë ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve (1979); (v) Konventë për mbrojtje fizike të materialit bërthamor (1980); (vi) Protokoll për shkatërrimin e

akteve të paligjshme të dhunës në aeroporte të cilat shërbejnë për aviacion civil ndërkombëtar, si plotësim i Konventës për shkatërrimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil (1988); (vii) Konventë për shkatërrimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar (2005); (viii) Protokoll i për shkatërrimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse të locuara në shkëmbin kontinental (2005); (ix) Konventa ndërkombëtare për shkatërrimin e sulmeve terroriste me bomba (1997); dhe (x) Konventa ndërkombëtare për shkatërrimin e financimit të terrorizmit (1999).

B

Cilido veprim tjetër me qëllim që të shkaktojë vdekjen dhe lëndimin e rëndë trupor të qytetarëve ose personave të tjerë të cilët nuk janë të përfshirë në përplasje ose përleshje i cili ka karakter të përplasjes së armatosur, me ç'rast qëllimi i këtij veprimi,

sipas natyrës ose kontestit të tij është të krijohet ndjenja e pasigurisë ose frikës tek qytetarët ose të detyrohet shteti ose ndonjë organizatë ndërkombëtare të kryejë ose të përmbahet nga kryerja e disa veprimeve të caktuara.

Financimi i terrorizmit

Financimi i terrorizmit është financim i akteve terroriste dhe

të terroristëve dhe organizatave terroriste.

Keqpërdorimi për qëllimet e financimit dhe

terrorizmit e financimit dhe terrorizmit

Ka të bëjë me shfrytëzimin nga terroristët dhe organizatat terroriste të OJF-ve për grumbullimin ose transferimin e mjeteve, sigurimin e mbështetjes logjistike, nxitjen

apo lehtësimin e rekrutimit të terroristëve ose mbështetjen ndryshe të terroristëve ose organizatave dhe operacioneve terroriste.

Vepra penale

financimi i terrorizmit

Vendet duhet ta kriminalizojnë financimin e terrorizmit në bazë të Konventës për shkatërrimin e financimit të terrorizmit, me ç'rast duhet ta kriminalizojnë jo vetëm financimin e akteve terroriste por edhe financimin e organizatave terroriste dhe terroristëve individualë dhe në mungesë të lidhjes me ndonjë akt terrorist konkret ose akte. Vendet duhet të kujdesen që

shkeljet e tilla të shënohen si vepra penale predikuese për larjen e parave.

Shpjegim: Ky rekomandim i zgjeron mundësitë për kriminalizimin e financimit të terrorizmit. Për shembull, organizata humanitare mund të akuzohet për financimin e terrorizmit nëse ka dhënë ndihmë për fëmijët e terroristëve.

Organizatave terroriste


Termi “organizatë terroriste” ka të bëjë me cilindo grup të terroristëve që: (i) kryen ose përpiqet të kryejë akt terrorist në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, në mënyrë të paligjshme ose të vetëdijshme; (ii) merr pjesë si bashkëpjesëmarrës në një akt

terrorist; (iii) organizon ose i urdhëron të tjerët të kryejnë akt terrorist ose (iv) kontribuon drejt zbatimit të aktit terrorist nga një grup personash që vepron me qëllim të përbashkët, me qëllim të realizimit të aktit terrorist ose me mësimin për qëllimin e grupit për të kryer aktin terrorist.

III.

HYRJE NË SISTEMIN PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT

Shtetet vendosin sistem për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, që shërben për mbrojtjen e sistemit financiar dhe sektorëve të tjerë real, duke e përfshirë edhe sektorin e OJF, nga keqpërdorimet e mundshme lidhur me larjen e parave dhe financimin e terrorizmit. Ky është sistem të cilin e definojnë politikat e tij dhe rregullativat të cilat janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare si edhe me numrin e madh të aktorëve të cilët kanë funksion dhe qëllim të ndryshëm.



„Nuk mund të potencohet mjaftueshëm se përfaqësuesit e shoqërisë qytetare shpesh janë të parët që alarmojnë për shkeljen e të drejtave të njeriut lidhur me PT, ndërsa njëherësh janë cak dhe janë të dëmtuar nga keqpërdorimi i vet masave për FT.”

DEKLARATË E ECNL NË JAVËN PËR PARANDALIM TË TERRORIZMIT
TË OKB-së, 2021.

RËNDËSIA E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Në nivel global ka numër të madh rastesh kur rregullimi i madh lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (PPP/PFT) në mënyrë të qëllimshme ose të paqëllimshme kryen ndikim negativ mbi organizatat jofitimprurëse (OJF). Qeveritë shpesh i arsyetojnë këto masa me pohimet se ato janë të domosdoshme që të harmonizohen me standardet e Grupit të punës për aksion financiar (FATF). Shembujt për ndikimin negativ mbi OJF përfshijnë:

- Shmangia e rrezikut nga bankat: bankat vendosin kërkesa joprporcionale ose në mënyrë të drejtpërdrejtë e kufizojnë qasjen ndaj shërbimeve financiare për OJF.
- Vendosja e kërkesave ngarkuese për të gjithë sektorin OJF në vend të masave të synuara të bazuara në rrezik për ato OJF të cilat i janë ekspozuar një rreziku të lartë.
- Përdorimi i standardeve të FATF për kufizimin e të drejtave themelore të njeriut dhe kufizimin e aktiviteteve të OJF.³

3 Shikoni më shumë: <https://ecnl.org/sites/default/files/2021-07/EaP%20AML%20CT%2002072021.pdf>

“...fokusi ynë kryesor duhet të jetë sigurimi se nuk do të prishet baraspesha delikate midis sigurisë nacionale dhe lirive si vlerë e lartë.”

E.T. Stevo Pendarovski, president i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Forumin rajonal të qeverive dhe shoqërisë qytetare, 2021.

Duke e pasur parasysh atë që rregullativa për PPP/PFT mundet në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndikojë në punën e OJF-VE, me rëndësi kryesore është që OJF-TË të jenë të vetëdijshme për këtë legjislaturë, ta mbrojnë organizatën e tyre si edhe në mënyrë proaktive të bashkëpunojnë me OJF të tjera, autoritete dhe palë të tjera të involvuara në krijimin e rrethimit politik i cili nuk do t'i kryejë aktivitetet ligjore të OJF-VE dhe do t'i mbrojë të drejtat e njeriut.

KORNIZA PËR PFT DHE PPP NË MAQEDONINË E VERIUT

Korniza për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit bazohet në standardet ndërkombëtare dhe është përcaktuar në **Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (Ligji për PPP/PFT)**⁴ që është pjesë kryesore e legjislaturës lidhur me këtë çështje dhe njëherësh e definojnë sistemin dhe përgjegjësinë e palëve të ndryshme të involvuara.

4 Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 317/220; 275/19; 120/18

Sistemi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit të Republikës së Maqedonisë së Veriut e përbëjnë institucione financiare dhe jofinanciare, organe shtetërore kompetente dhe trupa të cilët veprojnë në mënyrë parandaluese gjatë zbulimit dhe përndjekjes së personave të përfshirë në raste të LP dhe FT.

Në Maqedoninë e Veriut, **Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit** i definon subjektet të cilët obligohen të ndërmarrin masa dhe veprime për parandalimin dhe zbulimin e PP dhe FT, duke i definuar si **subjekte të detyruara**. Subjekte të detyruara janë institucionet financiare dhe jofinanciare siç janë agjencitë për patundshmëri, auditorët, kontabilistët, noterët, avokatët, kazinotë dhe të tjerë.

Subjektet e detyruara janë përgjegjëse për vendosjen e një sistemi intern për PPP dhe PFT që përbëhet prej rregullave interne, sektor i veçantë organizativ, person i emëruar dhe sistem elektronik i sofistikuar për përpunimin automatik të të dhënave.

Gjatë kryerjes së aktiviteteve dhe masave të tyre për PPP dhe PFT ata i njoftojnë dhe kryejnë analizë të klientëve të tyre (duke i përfshirë OJF) me të cilat hyjnë në marrëdhënie afariste. I ndjekin aktivitetet të cilat kryhen në kuadër të marrëdhënie afariste me klientët dhe i shtrojnë raportet deri tek **Drejtoria për Zbulim Financiar** për aktivitete që janë jashtë punës së zakonshme afariste. Për këtë qëllim, subjektet e detyruara bëjnë ndjekjen e vazhdueshme dhe analizë në bazë të të dhënave të grumbulluara, dokumenteve dhe informacioneve. Çdo transaksion i dyshimtë paraqitet në Drejtorinë për Zbulim Financiar.

Ligji për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit përmban nene për masat për kontroll paraprak që duhet t'i zbatojnë subjektet e detyruara në raste kur klientët e tyre janë OJF. Për momentin, ligji i konsideron të gjitha OJF për subjekte që janë lëndë e një kontrolli të përforcuar paraprak. Pritet se version më i ri Ligjit që përgatitet në momentin e shkrimit të këtij Doracaku do të mundësojë qasje të bazuar në rrezik e cila do t'i drejtojë subjektet e detyruara ta përdorin Vlerësimin e rrezikut nga financimi i terrorizmit për OJF në vend se të bëjnë kontroll të përforcuar paraprak për të gjitha OJF.

Pronësi e vërtetë

Në pajtim me standardet ndërkombëtare⁵ dhe direktivat e BE-së, nga vendet kërkohet të kenë informacione përkatëse, të sakta dhe në kohë për pronarët e vërtetë të personave juridikë të cilët organet kompetente munden t'i marrin në kohë. Në Maqedoninë e Veriut, **regjistri i pronarëve të vërtetë** është vendosur në janar 2021.

Termi “pronar” nuk është i zakonshëm për OJF dhe kjo është objekt i një debati ndërkombëtar pasi OJF-të nuk kanë pronarë në kuptimin klasik të fjalës. Megjithatë, në Maqedoninë e Veriut **OJF, si forma konkrete të personave juridikë, e kanë obligim ligjor t'i regjistrojnë pronarët e tyre të vërtetë.**

Për këtë qëllim, OJF duhet:



Ta identifikojnë pronarin/ët e tyre të vërtetë.

Përkufizimi i Ligjit përcakton se në rastin e OJF, pronari/ët e vërtetë janë:

- një person fizik i cili është i autorizuar ta përfaqësojë organizatën ose
- që ka pozitë kontrolluese në menaxhimin e pronës së organizatës, gjegjësisht **përfaqësuesin (përfaqësuesit) ligjor**.

OJF mund të kenë **një ose më shumë persona** të cilët e plotësojnë përkufizimin për pronarin e duhur.

Në praktikë, këta persona janë për shembull: kryetari, drejtori ekzekutiv, kryesuesi i Kuvendit, etj. Është e domosdoshme të merren parasysh aktet interne dhe struktura drejtuese e organizatës. Për shembull, fondacionet janë më specifike dhe pronarët e vërtetë mund të jenë persona që janë pjesë e themeluesve, këshillit, etj.



Ta regjistrojnë pronarin /pronarët e vërtetë

Regjistrimi bëhet në mënyrë elektronike përmes sistemit të Regjistrimit qendror.

OJF mund ta bëjë këtë në mënyrë të pavarur (nëse ka certifikatë digjitale dhe llogari të shfrytëzuesit në ueb faqe) ose përmes agjentit për regjistrim (kontabilistit të autorizuar).

Këshillë praktike: Meqë OJF nuk kanë pronarë, është e rëndësishme të zgjidhet opsioni “person fizik i cili në mënyrë tjetër realizon kontrollin e personit juridik” gjatë hyrjes në pjesën “03 Të dhëna për pronën” në kuadër të indikatorit për pronësi.



Të jenë të vetëdijshëm për afatet përfundimtare

OJF të sapoformuara i kanë 8 ditë për ta regjistruar pronarin/ pronarët e vërtetë. Në rast të ndryshimit të pronarit të vërtetë, gjithashtu i kanë 8 ditë për ta shënuar ndryshimin në regjistrin e pronarëve të vërtetë.

Nëse tejkalohen këto afate Regjistri qendror ka përcaktuar tarifa të cilat duhet të paguhen që të bëhet regjistrimi.

Këshillë praktike: Njoftoni personat përgjegjës në OJF tuaj se në rast të ndryshimit të personave të strukturës drejtuese të cilët janë të regjistruar si pronarë të vërtetë, ndryshimi duhet të paraqitet në Regjistrin qendror dhe në afat prej 8 ditësh nga ky ndryshim (kur Regjistri Qendror jep dokument që e përmban ndryshimin) duhet të azhurnohen informacionet në regjistrin e pronarëve të vërtetë.

Më shumë informacione për mbështetje lidhur me regjistrimin e pronarëve të vërtetë mund të gjeni në **linqet në vijim:**



- **Informacion të shkurtër për OJF**
- **Regjistri qendror: Përshkrimi i procedurës, parakushtet dhe kushtet e përdorimit**
- **Drejtoria për Zbulim Financiar: Udhëzimi për identifikimin e pronarit të vërtetë**
- **Drejtoria për zbulim financiar: Pyetje të parashtruara më shpesh**

Nëse hasni ndonjë problem, ju lutem kontaktoni me Konekt në **konekt@konekt.org.mk** ose në **02/3224 198**.

Drejtoria për Zbulim Financiar

Drejtoria për Zbulim Financiar (DZF) në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut është **institucion qendror në sistemin për PPP dhe PFT**. DZF është përgjegjëse për grumbullimin dhe analizimin e raporteve për transaksione të dyshimta (RTD) dhe informacione të tjera që janë relevante për parandalimin dhe zbulimin e LP dhe FT. Kur ekzistojnë baza për dyshim për LP dhe FT, DZF grumbullon të dhëna prej subjekteve të detyruara ose me kërkesë.



DZF kryen edhe detyra lidhur me mbikëqyrje dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Roli mbikëqyrës i DZF mundëson efektivitet të masave për PPP dhe PFT që i zbatojnë subjektet e detyruara. Në pajtim me Ligjin, mbikëqyrje mbi zbatimin e masave dhe aktiviteteve për PPP dhe PFT bëjnë: Drejtoria për Zbulim Financiar (në mënyrë të pavarur ose në koordinim me organe të tjera kompetente), Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Komisioni për Letra me Vlerë, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Financuara Kapitale të Penisioneve, Drejtoria e të

Ardhurave Publike, Agjencia për Postat, Oda e Noterëve dhe Oda e Avokatëve.

Anëtarësia e Grupit EGMONT⁶ edhe në platformat e tjera për bashkëpunim ndërkombëtar mundësojnë shkëmbim në kohë të të dhënave dhe informacioneve për zbatimin e analizës operative, si edhe bartjen e njohurive për qëllimet e përmirësimit të sistemeve të përgjithshme për mbrojtje.

Organe të tjera kompetente

Organet kompetente për përndjekjen e autorëve të PP dhe FT në Maqedoninë e Veriut janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Policia Financiare, Dretoria Doganore dhe Prokuroria Publike Themelore për përndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këto institucione njoftohen nga Drejtoria për Zbulim Financiar për raste ku ekzistojnë bazat e dyshimit për PP dhe FT pas çka ata veprojnë në pajtim me rregullat e procedurës penale për zbulimin dhe përndjekjen e autorëve të veprave penale.

Kur bëhet fjalë për sektorin e OJF, Ministria e Drejtësisë e zbaton rregullativën me të cilën rregullohet formimi, puna dhe ndjekja e sektorit OJF. Në procesin e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse i rëndësishëm është edhe roli i Regjistrimit qendror dhe gjykatave për organizatat fetare, me atë që ato mundësojnë mënyrë të shpejtë, të thjeshtë dhe të sigurt të regjistrimit të OJF në pajtim me kërkesat ligjore.

6 Egmont Grupi është trup i bashkuar i njësiteve të zbulimit financiar nga e mbarë bota.

Përshkrimi i punës bankare

Roli i bankave në sistemin për parandalimin e PP dhe FT është shumë i rëndësishëm. Arsye për atë është që **bankat dhe të punësuarit e tyre janë pika hyrëse në sistemin financiar** dhe janë drejtpërdrejtë të ekspozuar në rrezik nga futja e “parave të pista” në sistem. Sektori bankar përballet me presion që të sigurohet se nuk do të përdoret si kanal për larjen e parave dhe se nuk do të keqpërdoret për transferimin e mjeteve grupeve terroriste.

Nevoja e parandalimit të PP dhe FT, si edhe dënimet me të cilat përballen bankat në pajtim me rregullativën ligjore, i motivon të gjitha bankat të menaxhojnë me rrezikun nga krimi financiar. Si rezultat i kësaj, bankat kanë kërkesa rigoroze për “njoftimin me klientët e tyre” me të cilët bankat duhet të harmonizohen që ta parandalojnë qasjen e kriminelëve dhe terroristëve deri tek shërbimet financiare. Bankat detyrohen të kryejnë kontrolle paraprake për t’i grumbulluar informacionet vijuese për klientët e tyre duke i përfshirë edhe OJF:

- Ku punojnë;
- Me kë bashkëpunojnë;
- Kush i kontrollon;
- Burimi i tyre i mjeteve financiare.

Dorëzimi në kohë i informacioneve për transaksion të dyshimtë ose aktivitet të dyshimtë është elementi kryesor për zbulimin e veprave penale. Siç është rasti edhe me subjektet e tjera juridike, aktiviteti financiar i OJF mund të shihet përmes llogarisë bankare dhe ajo mund të çojë drejt paraqitjes së aktivitetit të dyshimtë nga banka

ose prej subjekteve të tjera të cilat janë të obliguara ta bëjnë këtë në bazë të ligjit. Kur Drejtoria për Zbulim Financiar do të marrë raport për transaksion të dyshimtë, institucionet veprojnë me kryerjen e kontroleve dhe zbatimin e masave përkatëse.

Bankat kryejnë analiza për klientët, duke i përfshirë edhe OJF, me ndihmën e qasjes së bazuar në rreziqet në pajtim me ligjin Bankat i identifikojnë transaksionet e dyshimta potenciale në bazë të përmbledhjes së indikatorëve të rregulluar në aktet nënligjore. Qëllimi i indikatorëve dhe çështjeve përcaktohet nëse OJF si klient ose transaksioni/aktiviteti i tij është i dyshimtë ose jo. Mund të ndodhë këta indikatorë të mos tregojnë menjëherë për një transaksion ose aktivitet të dyshimtë, por të çojnë drejt ndjekjes dhe analizës së mëtejme.

Shpesh OJF ankohen për kërkesat e stërngarkuara nga bankat. Ajo që është e rëndësishme që OJF-të ta kuptojnë për punën e bankave është si vijon:

→ Bankat duhet të marrin informacion për natyrën dhe përdorimin potencial të xhiro llogarive dhe shërbimeve;

→ Bankat duhet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut për PPP/PFT të çdo pronari në llogari, për përdorimin e parashikuar të xhiro llogarive dhe për transaksionet potenciale;


→ Bankat duhet t'i ndjekin transaksionet dhe aktivitetin e xhiro llogarive në pikëpamje të aktiviteteve të pazakonshme dhe të dyshimta.

Bankat e kanë për obligim t'i zbatojnë këto aktivitete për ta harmonizuar punën e tyre me Ligjin për PPP/PFT. Që këtu, në interes

të OJF-ve është t'i kuptojnë këto procedura, që t'i parashohin prej më parë t'i përgatisin informacionet për bankat. Kjo do të krijojë marrëdhënie të besimit midis bankave dhe OJF-ve si klientë të tyre.

Prandaj, rekomandime kryesore për OJF-të do të ishin t'i japin bankës informacione për:

- Historinë, madhësinë, lokacionin (lokacionet) e OJF, si edhe emrat dhe adresat e administratorëve/këshillit/anëtarëve të asamblesë dhe përshkrimi i sektorit specifik që i shërben OJF;
- Natyrën dhe misionin/qëllimet e OJF-së;
- Shfrytëzimin e planifikuar të llogarisë së kërkuar;
- Natyrën dhe madhësinë e aktivitetit të planifikuar të transaksionit;
- Azhurnimin periodik të ndryshimeve në informacionet lidhur me OJF, ose transaksione të cilat nuk janë në pajtim me aktivitetin paraprak.



Kur OJF bën transferimin e mjeteve në nivel ndërkombëtar, është e domosdoshme të bëhet si vijon:

→ Që përpara t'i dërgojë të gjitha informacionet shoqëruese deri tek banka;

→ T'i dërgojë të gjitha informacionet shtesë, relevante – OJF nuk guxon të presë të paraqitet një problem;

→ Gjatë transfertës së një shume të madhe mjeteve, jashtë skemës së zakonshme të aktivitetit të OJF, banka duhet që prej përpara të njoftohet për kohën, shumën dhe qëllimin e transfertës.

→ Ta informojë bankën për transaksione konkrete të cilat, nëse nuk elaborohen, mund të shkaktojnë shqetësim tek banka

Në vazhdim janë dhënë disa këshilla shtesë:


→ Do të ishte e dobishme nëse dokumentet statutores dhe informacionet për aktivitetet vijuese dhe aktivitetet e ardhshme janë në dispozicion në ueb faqen e OJF.

→ Nëse ndonjë përfaqësues i personelit kryesor të OJF akuzohet në mënyrë të rreme për krim financiar ose të përzier me ndonjë person i cili është dhënë në bazën e të dhënave për terroristë, banka duhet të njoftohet para se vetë ta zbulojë problemin.

→ Nëse OJF ka dilemë lidhur me disa transaksione të caktuara ose vëren sjellje të dyshimta tek ndonjë donator ose ndonjë palë tjetër e involvuar, duhet t'i drejtohet bankës dhe ta njoftojë për dyshimet që i ka.

→ OJF-ve, veçanërisht ato të cilat punojnë në vende me rrezik të lartë ose në vende ndaj së cilave janë vendosur sanksione, mund t'u shtrihen pyetje shtesë dhe në bazë të tyre të ndërmerren disa masa për kontroll paraprak.

→ Bankat mbështeten në bindjen se OJF-të si klientë të tyre do t'i kryejnë proceset e një kontrolli paraprak maksimalisht duke i shfrytëzuar aftësitë dhe resurset e tyre. Në këtë mënyrë, bankat dhe OJF do të sigurohen se të gjithë i përmbushin obligimet e tyre dhe do të sigurojnë mbrojtje më të mirë nga LP dhe FT. Shfrytëzoheni këtë doracak si vegël kryesore në këtë pikëpamje.



RREGULLATIVA NDËRKOMBËTARE

Ligjet nacionale janë zhvilluar në bazë të standardeve ndërkombëtare të cilat janë të definuara nga Grupi i Punës për Aksion financiar (FATF) në formë të rekomandimeve dhe rezultateve të drejtpërdrejta.

Standarde globale për PPP/PFT të cilat janë relevante për sektorin jofitimprurës

Grupi i punës për aksion financiar (FATF)⁷ është trup ndërkombëtar i cili i kushtohet parandalimit dhe sigurimit si përgjigje për larjen e parave dhe financimin e terrorizmit. Ky trup ka përgatitur standarde ndërkombëtare sipas së cilave matet harmonizimi teknik – 40 standarde të njohura si „Rekomandime⁸” – dhe efektiviteti – 11 standarde të njohura si „Rezultate të drejtpërdrejta.”⁹

FATF gjithashtu bën vlerësim për harmonizimin e standardeve drejtpërdrejt ose përmes disa prej trupave të veta rajonale siç është MONEYVAL i cili është përgjegjës për anëtarët e Këshillit të Evropës, duke e përfshirë Maqedoninë e Veriut¹⁰. Vlerësimi i harmonizimit

7 Shiko më shumë këtu: <https://www.fatf-gafi.org>

8 Shiko më shumë këtu: [https://www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/?hf=10&b=0&s=desc\(fatf_releasedate\)](https://www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/?hf=10&b=0&s=desc(fatf_releasedate))

9 Shiko më shumë këtu: https://www.fatf-gafi.org/publications/mutualevaluations/documents/fatfissuesnewmechanism_tostrengthenmoneylaunderingandterroristfinancingcompliance.html

10 Shiko më shumë këtu: <https://www.coe.int/en/web/moneyval/home>

të shteteve me Rekomanimet e FATF bëhet përmes recensionit profesional i cili rezulton me miratimin e raporteve për vlerësim të ndërsjellë.

Zbatimi i qëllimeve harmonizuese konsiderohet si vegël shumë efikase që të sigurohet zbatimi i politikave të FATF. Rezultatet e vlerësimit janë të rëndësishme pasi ato ndikojnë në rejtingun global të shteteve dhe zhvillimin e tyre. Në mënyrë konsekuente, harmonizimi me rekomandimet e FATF është me interes global për të gjithë aktorët. Për shembull, niveli më i ulët i harmonizimit me rekomandimet mund të çojë drejt presionit ndërkombëtar politik për ndryshimin e ligjeve, vlerësimet më të larta për rrezikun kreditor për shtetin, që nga ana tjetër ndikon mbi zhvillimin ekonomik, rezulton me kufizime për punën ndërkombëtare të bankave dhe sanksionet (në raste ekstreme).

FATF përmes trupave të tyre rajonal zbaton proces të vlerësimit të ndërsjellë gjatë së cilin vendet vlerësohen lidhur me nivelin e tyre të harmonizimit me secilin prej standardeve. Në vitin 2022, Maqedonia e Veriut do ta kalojë vlerësimin e pestë nga Komiteti i MONEYVAL i cili është pjesë e Këshillit të Evropës. Vlerësimi i ndërsjellë përfundon me raport në të cilin janë përfshirë vlerësimet vijuese për secilin prej Rekomandimeve të FATF: I Harmonizuar, I harmonizuar në masë të madhe, Pjesërisht i harmonizuar dhe I paharmonizuar. OJF janë të përfshirë në këtë proces që të vlerësohet harmonizimi i shteteve me Rekomandimin 8 për të cilin shumë shtete në botë kanë vlerësime të ulëta.

**Pë të mësuar më shumë
për procesin e vlerësimit
të ndërsjellë, shikoni Aneksin 1**

Qasja e bazuar në rrezik dhe sektori jofitimprurës

Pas sulmeve terroriste në SHBA më 11.9.2021, PFT në nivel ndërkombëtar u bë më rigoroz. U rrit frika nga keqpërdorimi i organizatave (përfshirë edhe ato jofitimprurëse) nga organizatat terroriste për qëllimet e bartjes së mjeteve dhe financimin e aksioneve të tyre. Si rezultat kësaj, Rekomandimi 8 i FATF e shfaqti sektorin e përgjithshëm të OJF si veçanërisht të cenueshëm lidhur me keqpërdorimin. Mungesa e dëshmisë përkatëse për këtë ka shkaktuar disa shtete të caktuara ta keqpërdorin këtë rekomandim për qëllimet e kontrollimit dhe rregullimit të madh të sektorit të OJF. FATF i rishikoi standardet e veta në vitin 2016 pas angazhimeve afatgjata për përfaqësimin global¹¹, duke ju bërë thirrje shteteve të zbatojnë qasje të bazuar në rrezik dhe ta respektojnë të drejtën ndërkombëtare si edhe të shmangin rregullimin e madh të OJF.¹²

Fokusi i qasjes së bazuar në rrezik i nxjerr në pah masat përkatëse, të drejtuara dhe efektive për pajtueshmëri. Për qëllimet e përmbushjes së standardeve të FATF, shtetet më shumë nuk mund të miratojnë rregullativa me spektër të gjerë të cilat kanë të bëjnë me të gjitha OJF duke pohuar se i gjithë sektori është i ekspozuar në rrezik. Në vend të kësaj, shtetet duhet të zbatojnë një process të rrezikut që të identifikohen ato OJF të cilat janë të ekspozuar në rrezik dhe më pas të ndërmarrin aktivitete përkatëse ligjdhënëse ose masa të tjera, të përshtatshme me rrezikun dhe të drejtuara drejt atyre OJF-ve tek të cilat është përcaktuar rreziku.

11 Shiko më shumë këtu: <https://ecnl.org/news/string-successes-changing-global-counter-terrorism-policies-impact-civic-space>

12 Përkufizimi i FATF për OJF: Personi juridik ose organizatë e cila fillimisht merret me grumbullimin dhe pagesën e mjeteve për

Standardet e FATF për sektorin e OJF

Ndryshimet në standardin e FATF për OJF (**Rekomandimi 8**) kanë për qëllim të sigurohen se OJF konsiderohen si “veçanërisht të cënueshme lidhur me keqpërdorimin për terrorizmin”. Tani në rekomandim është theksuar se *„shtetet duhet të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me organizatat jofitimprurëse që shteti i ka identifikuar si të pambrojtura ndaj keqpërdorimeve për qëllimet e financimit të terrorizmit. Shtetet duhet të aplikojnë masa të fokusuara dhe të përshtatshme, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik ndaj organizatave të tilla jofitimprurëse, për t’i mbrojtur ato nga keqpërdorimi me qëllim të financimit të terrorizmit....”*.

Gjatë vlerësimit të gjendjes lidhur me OJF, shtetet duhet të përmbushin dhe respektojnë disa standarde kryesore:

Qasje e bazuar në rrezik: „Shtetet duhet t’i identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë rreziqet e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit për shtetin dhe të ndërmarrin aktivitete... të drejtura nga sigurimi i lehtësimit efektiv të rreziqeve të tilla.” (Rekomandimi 1 i FATF)


Efektiviteti: „10.2. Deri në ç’masë, pa u prishur aktivitetet legjitime të OJF, shteti ka zbatuar qasje të drejtuar, ka realizuar aktivitete informative dhe ka kryer mbikëqyrje lidhur me veprimin e OJF-ve të cilat janë të ekspozuara në rrezik nga kanosja për keqpërdorim për terrorizëm?” (Rezultat i drejtpërdrejtë 10)

Respektimi i lirive kryesore: „Gjithashtu është e rëndësishme këto masa të zbatohen në mënyrë që do të sigurohet respektimi i obligimeve të shteteve që dalin prej Kartës së Kombeve të

Bashkuara dhe të drejtës ndërkombëtare për të drejta të njeriut”
(Shënim interpretuar drejt Rekomandimit 8)

Informimi i OJF: „Shtetet duhet të nxisin dhe të ndërmarrin programe informative dhe edukative për ngritjen dhe thellimin e vetëdijes tek OJF-të” (Metodologjia e FATF, 8.2(b))

Sipas kësaj, shtetet duhet t’i ndërmarrin hapat në vijim:



Burimi: Koalicioni global i OJF, www.fatfplatform.org

Kur këto standarde nuk janë të përmbushura, në raport për vlerësim të ndërsjellë nuk do të theksohet se shteti konsiderohet i harmonizuar me standardet e FATF lidhur me OJF.

Standardet e FATF përfshijnë vetëm Parandalimin e financimit të terrorizmit (PFT) në kuadër të Rekomandimit 8 konkretisht drejtuar drejt shtrimit të pyetjeve në sektorin e OJF. Sipas kësaj, FATF i imponon Qeveritë që ta rishikojnë dhe ta zbatojnë kornizën e tyre lidhur me Rekomandimin 8 për OJF vetëm lidhur me çështjet që lidhen me PFT.

Procesi i vlerësimit të ndërsjellë

Standarde të FATF për PPP

Standardet e FATF për Parandalimin e pastrimit të parave (PPP) janë pjesë e rekomandimeve të FATF.¹³ Megjithatë, këto **standarde të FATF për PPP janë drejtuar nga OJF. Shtesë, FATF në Dokumentin e vet për praktika më të mira¹⁴ për Rekomandimin 8 sqaroi se OJF-të nuk duhet të trajtohen si „subjekte të detyruara” me qëllim të pastrimit të parave.** Rekomandimet për pastrimin e parave përfshijnë çështje siç janë zbatimi përkatës i konventave ndërkombëtare, kriminalizimi i aktiviteteve të caktuara, kontrolli dhe verifikimi paraprak (KYC – njohja e shfrytëzuesve), vendosja e Njësitit për zbulim financiar (DZF – Drejtoria për Zbulim Financiar) dhe grumbullimi, ruajtja dhe shpërndarja e të dhënave.

Rekomandimet përfshijnë standarde lidhur me BPEJF (biznese dhe profesione të emëruara jofitimprurëse), pagesa alternative, pagesa devizore dhe pronësi të vërtetë. Megjithatë, **OJF nuk janë të përfshira në BPEJF në bazë të standardeve të FATF.** Mu për këtë, Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF kryesisht është e fokusuar në

13 Shiko Rekomandimet e FATF 10, 11, 20, 22, 23, 24.

14 Dokument për praktikën më të mira për luftë kundër keqpërdorimit të organizatave jofitimprurëse (Rekomandimi 8) (FATF, 2015)
„35. Kur ekziston dyshimi se një OJF e caktuar është keqpërdorur nga terroristë, vendet duhet të vendosin mekanizma përkatës që të sigurohen se informacionet e tilla dhe të gjitha informacionet e tjera relevante menjëherë do të ndahen me organe kompetente relevante me qëllim që të ndërmerren veprime parandaluese ose hetuese. Kjo nuk do të thotë se Rekomandimet e FATF kërkojnë prej vendeve t’ua imponojnë obligimin OJF për njoftim për transaksione të dyshimta, në pajtim me Rekomandimin 20. OJF nuk konsiderohen si biznese dhe profesione jofinanciare (BPEJF) dhe prandaj nuk duhet t’u nënshtrohen kërkesave të FATF për BPEJF”.

çështje lidhur me PFT edhe krahas asaj që ajo siguron këshilla t' dobishme për OSHC-të lidhur me aspektet lidhur me PPP. Ky doracak gjithashtu përfshin edhe udhëzime për OJF-të për rreziqet lidhur me PPP dhe masat lehtësuese.

Në raste kur shtetet në mënyrë jopërkatëse e pranojnë kornizën ligjore për siguri dhe luftë kundër terrorizmit si arsytim për kufizimin e lirive qytetare, FATF në menytë aktive vepron së bashku me institucionet e tjera, siç janë Raportuesit specialë të OKB-së, në kuadër të Zyrës së OKB-së të Komisarit të lartë për të drejta të njeriut, deri tek të cilat mund të drejtohen OJF-të. Lexoni më shumë lidhur me rastin e paracakohshëm në Serbi në linkun vijues

<https://ecnl.org/news/what-can-csos-do-when-they-face-abuse-or-over-regulation-caused-amlcft-standards>

Korniza e standardeve të BE-së për PPP

Direktiva 2015/849 e BE-së nga viti 2015 është pjesë e legjilativës për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.¹⁵ Megjithatë, si edhe standardet e FATF-së, në direktivën e BE-së nuk janë përfshirë OJF si subjekte të detyruara.

Në nenin 4 të Direktivës shteteve u lejohet “në pajtim me qasjen e bazuar në rrezik” ta zgjerojnë listën e subjekteve të detyruara deri tek kategoritë e ndërmarrjeve “të cilat janë të përfshira në

15 Shiko më shumë këtu: https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/banking-and-finance/financial-supervision-and-risk-management/anti-money-laundering-and-counter-terrorist-financing_en

aktivitete për të cilat është veçanërisht e sigurt të shfrytëzohen për qëllimet e pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit”. Shtimi i kategorive për persona dhe aktivitete krahas atyre që janë dhënë në Direktivë duhet të bazohet në besimin e dëshmuar ose rrezikun se të njëjtat do të shfrytëzohen për larje të parave ose financimin e terrorizmit. Sipas kësaj, përfshirja e OJF mund të bazohet vetëm në qasjen e bazuar në rrezik, pas kryerjes së vlerësimit në rrezik konkret për qëllimet e identifikimit të OJF-ve me rrezik të lartë nga keqpërdorimi i pastrimit të parave dhe jo për të gjitha OJF-të. Sipas Direktivës së BE-së, masat e shteteve gjithashtu duhet të jenë në pajtim me Kartën për të drejtat bazë të BE-së¹⁶, e cila përfshin të drejtën e asociimit.

Përfshirja e përgjithshme e të gjithëve (ose grupeve gjenerike të) OJF-ve e prishë këtë të drejtë pasi shkakton obligime joproporcionale ose obligime të mëdha lidhur me shfrytëzimin e lirive të kësaj të drejte. Qeveritë mund t’i kufizojnë të drejtat nëse kjo është në interes publik. Megjithatë, ky kufizim nuk guxon t’i tejkalojë absolutisht masat e domosdoshme.

Që të mësoni se si shtetet angazhohen me OJF-të në bazë të rekomandimeve të FATF, shikoni në Aneksin 2

16 Shiko më shumë këtu: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>

ANGAZHIMI I FATF NË SEKTORIN E OJF-VE

Pas rishikimit të Rekomandimit 8 në vitin 2016, FATF filloi angazhim më formal dhe më konsekuent në sektorin e OJF-së përmes Forumit të vet konsultativ për sektorin privat ku OJF-të janë të ftuara të marrin pjesë dhe ku Koalicioni global i OJF-ve për FATF i ka katër pozita për qëllimet e përfaqësimit të sektorit.¹⁷ **Gjithashtu, para ca kohësh FATF hapi kanal komunikimi** për sektorin jofitimprurës për ngritjen e çështjeve dhe sigurimin e kontributit gjatë procesit të vlerësimit të ndërsjellë.¹⁸

Angazhimi i OJF-ve në procesin e vlerësimit të rrezikut

Drejtimet dhe standardet e FATF nxisin informim dhe konsultim me sektorin e OJF-ve gjatë zbatimit të procesit të vlerësimit të rrezikut.¹⁹ Në mënyrë ideale, sektori i OJF do të ishte i pranishëm gjatë përcaktimit nga Qeveria nëse sektori është i ekspozuar ndaj rrezikut nga keqpërdorimi i financimit të terrorizmit. Ekzistojnë disa vegla të dobishme të cilat mund të përdoren për angazhimin e sektorit të OJF në këtë process.

17 Shiko më shumë këtu: <https://ecnl.org/news/ecnl-and-partners-global-npo-coalition-offered-seats-fatfs-private-consultative-forum>

18 Shiko më shumë këtu: <https://www.fatf-gafi.org/faq/mutualevaluations/#d.en.448461>

19 Shiko më shumë këtu: <https://www.fatf-gafi.org/publications/methodsandtrends/documents/terrorist-financing-risk-assessment-guidance.html>


Anketa në sektorin e OJF-së

Anketat më të përgjithësuar në sektorin e OJF-së mund të ndihmojnë për grumbullimin e informacioneve lidhur me perceptimin e rrezikut dhe problemeve fillestare (më të përgjithësuar) të OJF-ve lidhur me rrezikun nga FT.

Duhet të përmendet se çdo anketë duhet të shoqërohet me aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe informimit për qëllimet e a) rritjes së mirëkuptimit dhe theksimin e rëndësisë për këtë aktivitet dhe b) lehtësimin e sigurimit të përgjigjeve.

Dialog dhe konsultime lidhur me perceptimet për rrezikun

Qëllimi i dialogut të fokusuar dhe konsultimeve është grupet më të vogla të OJF-ve të cilat është më e sigurt se janë të ekspozuara ndaj rrezikut prej keqpërdorimit për FT (ose atyre që paraprakisht janë identifikuar si të ekspozuar ndaj këtij rreziku) për t'i diskutuar problemet vijuese, perceptimet dhe masat e vazhdueshme për zbatim që të sigurohet material për procesin e Vlerësimit të rrezikut.



Përfshirja e kontributit nga sektori i

Kontributi nga sektori i OJF është e rëndësishme të përfshihet në konstatimet dhe rekomandimet nga vlerësimi i rrezikut, pasi informacionet e siguruara mund të ndihmojnë për identifikimin e problemeve, masave për zbutje dhe përmirësimet potenciale

OJF-ve në vlerësimin e rrezikut

si për OJF, ashtu edhe për Qeverinë. Kjo gjithashtu i mundëson sektorit të OJF-ve të japë kontribut të konsiderueshëm ndaj diskutimit lidhur me rrezikun e financimit të terrorizmit me aktivitete reale, të zbatueshme dhe konkrete.

Metodologji të vlerësimit të përbashkët të rrezikut

Në pajtim me qasjen për bashkëpunim të ndërsjellë, Vlerësimi i përbashkët i rrezikut në sektorin për OJF e imponon nevojën e vlerësimit për ta kryer zyrtarisht grupin e vendosur i cili i përfaqëson të gjitha pjesët relevante të qeverisë dhe sektorit të OJF. Grupi ndihmon gjatë grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve dhe jep komente dhe këshilla lidhur me analizat, konkluzat dhe rekomandimet.

Për të mësuar më shumë lidhur me shtetet të cilat janë shembuj të mirë, shikoni në Aneksin 3

Është e rëndësishme të potencohet se në Maqedoninë e Veriut Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF ishte realizuar në pajtim me qasjen për bashkëpunim të ndërsjellë nga një grup pune në të cilin bënin pjesë institucione dhe OJF.

Mënyra në të cilat OJF-të mund të angazhohen në nivel global/rajonal

Shoqëria civile përballet me sfida të ndryshme lidhur me zbatimin e rekomandimeve të FATF. Ato disponojnë me disa drejtime të cilat mund t'i ndjekin qëllimet e ngritjes së çështjeve të tyre:

1

Ngritja e çështjeve tek FATF si pjesë e punës së tyre për identifikimin e pasojave të paqëllimshme ose para një procesi të ardhshëm të vlerësimit të ndërsjellë. Në shkurt të vitit 2021, FATF filloi nismë për studimin e pasojave të paqëllimshme nga zbatimi i papërshtatshëm i standardeve të FATF, veçanërisht për OJF-të.²⁰

2

Ngritja e çështjes në kuadër të Procedurave të ndryshme speciale të OKB-së, për shembull, tek Raportuesi special për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore gjatë luftës kundër terrorizmit, si ekspert i pavarur i emëruar nga Këshilli për të drejta të njeriut të OKB-së. Raportuesit special mund të kërkojnë elaborim dhe ta ngritin çështjen para qeverisë përkatëse ose ndonjë organi tjetër kompetent për PPP/PFT.²¹

20 Shiko më shumë këtu: <https://www.fatf-gafi.org/publications/financialinclusionandnpoissues/documents/unintended-consequences-project.html>

21 Shiko më shumë këtu: <https://www.ohchr.org/en/issues/terrorism/pages/srterrorismindex.aspx>

Raportimi tek mekanizmi rajonal për të drejta të njeriut, siç është Këshilli i Evropës, për shembull, Komisari për të drejta të njeriut ose Konferenca e Organizatave ndërkombëtare joqeveritare.²²

Nisma globale për angazhimin e OQ në FATF dhe trupave të tjerë për luftë kundër terrorizmit

Koalicioni global i OJF për FATF²³ është rrjet fleksibil i organizatave të ndryshme jofitimprurëse. Koalicioni bën përfaqësim për qëllimet e mbrojtjes së sektorit të OJF lidhur me standardet e FATF, përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të vlerësimeve të ndërsjella të FATF, me informimin e vazhdueshëm të sektorit të OJF, të bazuar në rrezik, zbatimin e Rekomandimeve të FATF të cilat ndikojnë mbi OJF, veçanërisht Rekomandimi 8. Qëllimi është të zbuten pasojat e paqëllimshme nga politikat për parandalimin e terrorizmit të financimit (PFT) mbi shoqërinë civile, me qëllim që të prishet aktiviteti legjitim i OJF. Agjenda e përfaqësimit lëvizë nga ndryshimet në politikat në nivel të FATF si edhe në nivel global dhe nacional, të cilat kërkojnë aksion dhe angazhim të shpejtë nga OJF-të. Koalicioni ka vendosur marrëdhënie konstruktive me Sekretariatën e FATF dhe në mënyrë të suksesshme të japë kontributin e vet ndaj ndryshimeve të politikave.

22 Shiko më shumë këtu: <https://www.coe.int/en/web/ingo>; <https://www.coe.int/en/web/commissioner>

23 Shiko më shumë këtu: <https://fatfplatform.org>

Koalicioni i shoqërisë civile për të drejta të njeriut dhe luftë kundër terrorizmit

Koalicioni i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut dhe Luftën kundër Terrorizmit i përfshin mbi 30 organizata ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të të drejtave të njeriut, organizata humanitare dhe organizata paqësore. Është një koalicion fleksibël i organizatave që punojnë me organet e OKB-së që punojnë në çështjet kundër terrorizmit për të avokuar për përfshirje më të madhe të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile në standardet dhe praktikatat e OKB-së, si dhe zbatimin e bazuar në të drejtat e njeriut në politikatat dhe praktikatat për luftë kundër terrorizmit. Organizatat qytetare të nivelit nacional mund t'i bashkohen koalicionit për të ndihmuar në dokumentimin e rasteve dhe për të rritur ndërgjegjësimin për politikatat kundër terrorizmit të qeverive kombëtare, por edhe ndikimin e organeve të OKB-së mbi hapësirën qytetare dhe të drejtat e njeriut, angazhimin në avokimin global për të forcuar normat e OKB-së dhe për t'u angazhuar me organet e OKB-së për të ndarë praktikatat dhe rekomandimet.


Nëse jeni të interesuar në mënyrë proaktive të merreni në nivel global ose nacional me përgatitjen e politikave në këtë sferë, ju lutemi të kontaktoni me Konekt.

IV.

QASJE E BAZUAR NË RREZIË DHE RELEVANCA E SAJ PËR OJF-NË TUAJ

MËNYRAT NË TË CILAT OJF-TË MUND TË KEQPËRDORIN PËR QËLLIMET E FT

Edhe pse ekzistojnë disa rreziqe të caktuara OJF-të të keqpërdoren për FT, sipas analizës së FATF, rastet e keqpërdorimit të OJF-ve për qëllimet e FT janë shumë të rralla. Në raportin e vet²⁴ për analizimin e rasteve reale të keqpërdorimit të OJF, FATF i definon metodat dhe rreziqet vijuese për keqpërdorim të cilat mund të jenë të dobishme për shqyrtim gjatë përcaktimit të rreziqeve për organizatën tuaj.



Metoda dhe rreziqe nga keqpërdorimi

Ridestnimi i mjeteve financiare	OJF, ose individ i cili vepron në emër të OJF, ridestinin e mjeteve financiare ndaj një organizate të njohur terroriste ose organizate për të cilën ekzistojnë dyshime se është terroriste
Përkatësia e organizatës terroriste	OJF, ose individ i cili vepron në emër të OJF, mban lidhje operative me organizatën terroriste ose me një mbështetës të terrorizmit
Keqpërdorimi i programit	Programe të financuara nga OJF të dedikuara për mbështetjen e qëllimeve humanitare legjitime dhe që manipulohen me qëllim të sigurimit të mbështetjes së terrorizmit
Mbështetje për rekrutim	Programe ose aktivitete të financuara nga OJF përdoren për krijimin e mjedisit të volitshëm për mbështetje dhe/apo promovimin e aktiviteteve lidhur me rekrutimin e terroristëve
Prezentim i rrejshëm dhe OJF të rrejshme	Nën paravanin e aktivitetit humanitar, një organizatë e caktuar ose individ mbledh mjete dhe/apo kryen aktivitete të tjera për mbështetjen e terrorizmit

Në vazhdim janë dhënë disa shembuj ndërkombëtarë të Raportit të FATF me të cilat shfaqen metodat e keqpërdorimit²⁵

**Ridestnimi i
mjeteve
financiare**

RTD janë dorëzuar deri tek DZF për përfaqësinë vendore të OJF me seli jashtë vendit, të vendosur në listën lokale. OJF vendore ka kryer transferët të mjeteve deri tek OJF e ndaluar me seli jashtë vendit përmes llogarisë bankare në një vend të tretë. Gjithashtu është bërë transferimi i mjeteve deri tek organizatat jofitimprurëse në fushat me rrezik të lartë dhe marrjen e parave të gatshme në bankomate të mëdha. Hulumtimi i DZF ka përcaktuar përfaqësues përgjegjës të OJF-ve vendore të cilat kanë transferuar shuma të mëdha të parave të gatshme jashtë shtetit. Në raportet e zbulimit financiar lidhur me lëvizjen ndërkufitare të parave të gatshme, përfaqësuesit përgjegjës kanë theksuar se mjetet kanë qenë donacione të dedikuara për aktivitete humanitare të locuara në fusha me rrezik të lartë dhe të ulët. OJF vendore gjithashtu ka kryer transfertë mjetesh edhe në OJF-në e dytë lokale. RTD të dorëzuara për OJF-në e dytë kanë treguar se përfaqësuesit përgjegjës të kësaj OJF-je kanë kryer transfertë mjetesh ndaj individëve në vende të zhvilluara në rajon që nuk kanë lidhje me fushëveprimin e OJF-ve. Si rezultat i hetimit, OJF-ja vendore është futur në listë si mbështetëse e terrorizmit dhe mjetet e saj janë ngrirë.²⁶

25 Ibid

26 Ibid – Studim rasti 3

**Përkatësia e
organizatës
terroriste**

OJF e bazuar jashtë vendit, e futurë në listen e zetë në më shumë vende për shkak të dyshimit për lidhjet e saj me ndonjë organizatë të caktuar terroriste, ka kryer transfertë mjetesh për më shumë OJF vendore. Informacionet e dorëzuara deri tek DZF nacionale nga organet për zbatimin e ligjeve dhe sigurinë nacionale kanë treguar se OJF-të vendore kanë qenë nën dyshimin se sigurojnë mbështetje ideologjike dhe financiare të grupeve ekstremiste, përfshirë edhe organizata vendore terroriste të cilat janë vendosur në listen e zezë. Sipas zbulimit financiar, OJF e bazuar jashtë vendit ka kryer transfertë në shumë më të madhe se 100 000 USD në një qendër fetare vendore. Drejtori i qendrës fetare ka qenë nën dyshim se i përdorë llogaritë e veta bankare, si dhe atë të qendrës fetare, për sigurimin e mbështetjes financiare të grupeve ekstremiste, përfshirë edhe organizata vendore të futura në listen e zezë. Informacionet e siguruar nga DZF kanë treguar se ky individ paraprakisht ka folur në dobi të një aktiviteti terrorist. DZF zbuloi gjithashtu se një OJF ndërkombëtare e kontrolluar nga një OJF me seli në një shtet të huaj transferoi më shumë se 150.000 dollarë në një qendër tjetër fetare vendase. Për këtë qendër tjetër, DZF zbuloi se ishte e lidhur me një komplot terrorist vendor. Për më tepër, OJF jashtë shtetit dhe filialet e saj kanë transferuar afërsisht 120.000 dollarë në një OJF të tretë vendore.

Kjo OJF e tretë ishte tashmë lëndë interesi për DZF-në, sepse ajo kishte transferuar mjete tek një OJF e huaj e njohur si një organizatë pas së cilës fshihen grupet terroriste. Sipas informacionit të dhënë në DZF nga një partner i Komunitetit të sigurisë dhe inteligjencës vendore, përfaqësuesi përgjegjës i OJF-së së tretë përdori pozicionin e tij për të promovuar një ideologji radikale. OJF e tretë gjithashtu ka marrë transfertë elektronike të mjeteve nga OJF e dytë ndërkombëtare në shumë prej afro 1.000.000 USD. Sipas informacioneve të dorëzuara deri tek DZF, OJF e dytë ndërkombëtare ka dashur ta përforcojë agjendën e saj për radikalizimin me sigurimin e ndihmës financiare për subjektet vendore me një lidhshmëri të caktuar me ekstremizmin.²⁷

***Keqpërdorimi
i programit***

Autoriteti Rregullator Kombëtar për OJF-të ka nisur një hetim për pretendimet në media se një OJF vendase e krijuar me qëllim të promovimit të arsimit, drejtohej nga anëtarë të lartë dhe aktivistë të një grupi që promovonte ekstremizmin e dhunshëm. Këta individë dyshohet se përdorën shkollë të mbuluara nga OJF-të për të mësuar dhe promovuar ekstremizmin që dihej se rezultonte në dhunë. Rregullatori u qas dhe i shqyrtoi disa burime informacioni, duke përfshirë informacionet

27 Ibid – Studim rasti 52

e dhënë nga mediat në mbështetje të këtyre pretendimeve, informacionet e dhënë nga vetë OJF-ja dhe materialet e ofruara nga Këshilli i arsimit. Nga hetimi i rregullatorit u zbulua se një nga përfaqësuesit përgjegjës të OJF-së ishte ish-anëtar i një organizate që merrej me radikalizimin në drejtim të dhunës. Megjithatë, anëtarësimi i përfaqësuesit përgjegjës ka pushuar disa vite më parë dhe ai nuk ishte më dakord me disa nga pikëpamjet politike të organizatës radikale. Rregullatori zbuloi gjithashtu se një nga përfaqësuesit përgjegjës të OJF-së ishte i martuar me një individ që vepronte si përfaqësues në media për organizatën radikale. Mirëpo, edhe ajo marrëdhënie u ndërpre me publikimin e një reportazhi në media.²⁸

Mbështetje për rekrutim

Një shtetas i huaj ka kryer një dërgesë në valutë nga llogaria e tij personale në një bankë jashtë vendit në llogarinë e një OJF-je vendase. Në shpjegimin e kërkesës, shtetasi i huaj iu referua sponsorizimit të një individi. Në veçanti, fondet synonin të mbulonin koston e jetesës së një individi të caktuar. Një hetim nga DZK kombëtare zbuloi se individ i sponsorizuar ishte në një listë të personave të dyshuar si terroristë. Hetimi zbuloi gjithashtu se OJF-ja ishte e lidhur ngushtë me një rrjet grupesh që financonin aktivitetin terrorist.²⁹

28 Ibid – Studim rasti 77

29 Ibid – Studim rasti 84

**Prezentim
i gabuar i
OJF-ve të
rrejshme**

Dy individë po mblidhnin mjete financiare në nivel vendor për një anëtar të familjes që kishte luftuar përkrah një organizate terroriste të krijuar si e tillë jashtë vendit. Individët që pretendonin se ishin anëtarë të një OJQ-je të njohur vendore të ndihmës humanitare siguruan fonde duke mbledhur para në rrugët publike. Aktivitetet e mbledhjes së mjeteve ishin në kundërshtim me ligjin vendor. Individët individualë nuk kishin pëlqimin e OJF-së vendore për të mbledhur donacione në emër të saj dhe as nuk i dorëzonin fondet e mbledhura në atë OJF. Pasi u grumbullua një shumë e konsiderueshme parash, ato i dërgoheshin familjarit jashtë vendit duke përdorur pagesat devizore. Si rezultat i një hetimi të përbashkët nga DZF, rregullatori i OJF-ve dhe organet e zbatimit të ligjit, të dy individët u arrestuan dhe u akuzuan për mbledhje të mjeteve apo fondeve për terrorizëm dhe u dënuan me burg³⁰

PËRSHKRIM I VLERËSIMIT TË RREZIKUT NGA FT PËR OJF-TË NË MAQEDONINË E VERIUT

Në pajtim me standardet dhe rekomandimet e FATF të cilat kanë të bëjnë me OJF-të, ndërsa të cilat janë përhkruar në kapitullin paraprak, në vitin 2021 Republika e Maqedonisë së Veriut e dha një raport për vlerësimin e zbatuar të rrezikut nga financimi i terrorizmit për organizatat jofitimprurëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF).

Qëllimi i Vlerësimit të rrezikut nga FT për OJF ishte të sigurohet harmonizimi dhe implementimi i Rekomandimit 8 dhe Rezultati i drejtpërdrejtë 10³¹ që e mundëson zbatimin e qasjes së bazuar në rreziqe dhe masa proporcionale për mbrojtjen e OJF të cilat janë identifikuar si të cenueshme. Raporti i plotë për Vlerësimin e rrezikut nga FT për OJF është në dispozicion publikisht në ueb faqen e **Drejtorisë për Zbulim Financiar** www.ufr.gov.mk në linkun vijues <<link>>. Në këtë kapitull është dhënë shqyrtimi i konstatimeve kryesore dhe shpjegimi i kuptimit të tyre.

Kush e përgatiti Vlerësimin e rrezikut nga FT për OJF-të?

Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF-të është një dokument i miratuar nga Qeveria. Raporti për vlerësimin e kryer përgatitet nga një grup pune ndërsektorial i përbërë nga përfaqësues të institucioneve

31 FATF **Rezultat i drejtpërdrejtë** 10: Terroristët, organizatat terroriste dhe financuesit e terrorizmit janë parandaluar në grumbullimin, lëvizjen dhe përdorimin e mjeteve dhe keqpërdorimin e sektorit OJF. Burimi: FATF.

shtetërore përgjegjëse për themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe monitorimin e OJF-ve, të koordinuar nga Drejtoria për Zbulim Financiar, si dhe përfaqësues të OJF-ve, të koordinuar nga Shoqata Konekt Shkup.³² Procesi përfshiu konsultime të gjera dhe qasje participuese.

Për të kryer këtë vlerësim është përdorur Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut nga Financimi i Terrorizmit për OJF-të e Greenacre Group. Përgatitja dhe promovimi i Vlerësimit të Rrezikut nga FT për OJF-të përfshinte mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, ngritjen e kapaciteteve, seminare, konsultime dhe angazhim me palët e interesuara, prezantimin e konstatimeve në një sërë ngjarjesh kombëtare dhe ndërkombëtare të mbështetura nga Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse, Shoqëria gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), USAID dhe partnerë dhe donatorë të tjerë.

Cilat janë përfitimet nga Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF-të?

Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF-të:

mundëson që shteti të harmonizohet me standardet ndërkombëtare, ndërsa OJF t'i kuptojnë rreziqet me të cilat përballen dhe seriozitetin e tyre

32 Ekipi i grupit të punës për Vlerësimin e rrezikut nga FT për OJF përbëhej nga 14 anëtarë, 8 nga institucionet publike dhe 6 nga OJF-të. Grupi përbëhej prej 25 profesionistëve (anëtarë dhe zëvendësanëtarë).

është dokument që përmban informacione të dobishme për zhvillimin e sistemit efikas për mbrojtjen e OJF-ve nga keqpërdorimi i tyre për qëllimet e FT. Masat për zbutjen e rreziqeve i zbatojnë institucionet shtetërore, institucionet financiare dhe vetë OJF-të.

siguron bazë solide për përmirësimin e mëtejshëm dhe zhvillimin e masave të tilla për zbutje pasi: e vlerëson nivelin e rrezikut për nëngrupe të caktuara të sektorit OJF në vend; i definon faktorët e rrezikut dhe jep shqyrtim për gjendjen momentale dhe jep rekomandim për aktivitete të mëtejme, etj.

u mundëson të gjithë faktorëve të definojnë ose shtesë të zhvillojnë masa të cilat janë të bazuara në rreziqe, të cilat janë proporcionale dhe nuk i pengojnë aktivitetet legjitime të OJF dhe lirinë e bashkimit.

me angazhimin e përbashkët të palëve të tjera të involvuara që siguron mbështetje, disa aktivitete të caktuara janë pranuar ndërkombëtarisht si praktikë e mirë pasi procesi mundësoi ngritjen e vetëdijes për kuptimin e kanosjeve dhe potencialin për ekzistimin e rreziqeve për FT në sektorin e OJF dhe siguruan platformë për bashkëpunim më të fuqishëm midis institucioneve relevante, sektorin e OJF-së dhe faktorët e tjerë në këtë sferë.

Çfarë përmban Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF?

Raporti për Vlerësimin e rrezikut nga FT për OJF përmban informacione për:


nëngrupi i organizatave të cilët bien në definimin e OJF në FATF

karakteristikat dhe llojet e OJF të cilat, sipas aktiviteteve apo karakteristikave të tyre, me siguri janë të ekspozuar në rrezik nga keqpërdorimi i financimit të terrorizmit

kanosja nga financimi i terrorizmit për organizatat jofit-imprurëse në Republikën e Maqedonisë

shqyrtimi i përshtatshmërisë së masave, përfshirë edhe ligjet dhe rregullat, të cilat kanë të bëjnë me nëngrupin e OJF që mund të keqpërdoren për mbështetjen e financimit të terrorizmit siç janë: ligje dhe rregulla; masa për zbatim lidhur me politikat dhe përfshirjen e OJF; dhe masa në OJF

masa dhe aktivitete të rekomanduara të cilat ofrojnë qasje proporcionale dhe efektive për përballjen me rreziqet e identifikuar;



Cilat janë konstatimet kryesore të Vlerësimit të rrezikut nga FT për OJF dhe çfarë do të thonë ato?

Subjektet juridike në vijim bëjnë pjesë në definicionin për OJF të FATF: shoqata (rreth 65% e subjekteve juridike), fondacione, Kryqi i Kuq, organizata joqeveritare vendore dhe të huaja, kisha, bashkësi fetare dhe grupe religjioze.

ELABORIM:

Në fokusin e vlerësimit të rreziqeve ishin OJF të cilët bëjnë pjesë në definimin e OJF të FATF. Në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë subjekte juridike jofitimprurëse të cilët bëjnë pjesë në definicionin e FATF siç janë: sindikatat, shoqatat e banuesve, partitë politike, grupet joformale të interesit dhe nismat qytetare. Pjesë e subjekteve juridike të cilat regjistrohen si shoqata nuk janë OJF sipas FATF siç janë shoqatat profesioniste (zanatet) dhe klubet sportive³³ të cilat janë në interes të anëtarëve. Këto subjekte nuk ishin pjesë e analizës dhe vlerësimit të rreziqeve.

Nuk janë evidentuar raste të aktgjykimeve, akuzave, masave rregullatore, hetime aktive dhe të mbyllura lidhur me financimin e terrorizmit në sektorin e OJF në Maqedoninë e Veriut.

33 Organizata që merren me veprimtarinë më të gjerë dhe sportin rekreus bëjnë pjesë në definimin e FATF për OJF.

ELABORIM:

Në periudhën e vitit 2017, 2018 dhe 2019 deri tek DZF janë dorëzuar 4 raporte për transaksione të dyshimta për financimin e terrorizmit të cilat involvojnë OJF-të. Në mungesë të rasteve formale që të vlerësohen kanosjet, faktorët e rrezikut dhe që të identifikohet niveli i rrezikut inherent dhe rezidual për sektorin e OJF, u zbatua analizë e madhe e të dhënave primare dhe sekondare, duke përfshirë informacione zbuluese për analiza dhe vëzhgime.

Janë identifikuar tre tipa të kanosjeve për OJF lidhur me keqpërdorimin e tyre për financimin e terrorizmit.

Natyra e kanosjeve nga financimi i terrorizmit për OJF në RMV:

- | Keqpërdorimi i OJF për promovimin e radikalizmit fetar
- | Keqpërdorimi i OJF për rekrutimin e personave
- | Keqpërdorimi i OJF për mbështetje logjistike

Duke e pasur parasysh se nuk është përcaktuar ekzistimi i lidhjes së drejtpërdrejtë të përfshirjes së OJF përmes ridedikimit të mjeteve ose keqpërdorimit të mjeteve ose një lloji tjetër të aktivitetit konsiderohet se shkalla e kanosjes është e ulët. Natyra e kanosjeve për keqpërdorimin e OJF janë përcaktuar në pjesën e indoktrinimit të radikalizmit fetar, përmes bursimit të arsimit në shtete të tjera, rekrutimit të personave, mbështetjes logjistike siç është keqpërdorimi i pajisjes për shtypje dhe hapësira, etj. Shikoni rastet ndërkombëtare të keqpërdorimit në faqen 48.

Faktorë të rrezikut:

- Udhëheqësia e OJF janë persona eksponentë të një ideologjie radikale fetare;
- OJF janë regjistruar ose janë aktivë në rajone të përcaktuara si të rrezikshme për terrorizmin;
- Donacione/sponsorime të transferuara prej vendeve me rrezik të lartë ose vende në të cilat ka konflikte ose luftëra;
- OJF nuk sigurojnë informacione për aktivitetet e tyre dhe transaksionet e kryera financiare në mënyrë në të cilën mund të verifikohet nga institucionet.

Në Vlerësimin e rrezikut nga FT për OJF janë definuar faktorët të rrezikut të cilët mund të çojnë drejt realizimit të rrezikut. Në vazhdim është dhënë shpjegim për çdo faktor të rrezikut që është brenda raportit:

Udhëheqësia e OJF janë persona eksponentë të një ideologjie fetare radikale.

Agjencitë për zbulim tregojnë për involvimin e personave me diskurs radikal religjioz të cilat paraqiten në strukturën themeluese ose drejtuese të OJF. Është vërejtur lidhje midis grupeve etnike, religjioze ose socio-kulturore për të cilat dihet se janë të ndjeshëm në lëvizjet ekstremiste. Kjo është vërejtur edhe me tipologjitë ndërkombëtare, ku vërehet se OJF mund të përdoren edhe për përhapjen e ideologjive ekstremiste, për rekrutimin e personave në qëllime ekstremiste dhe për mbështetjen e lutëtarëve të huaj terroristë. **Një keqpërdorim i tillë akoma nuk është vërejtur në RMV.**

OJF janë regjistruar ose janë aktivë në rajone të përcaktuara si të rrezikshme për terrorizmin.

Sipas vlerësimit të kryer të rrezikut nga terrorizmi nga shërbimet për zbulim janë hartuar rajone në të cilat ekziston rrezik i lartë nga terrorizmi. Ky konstatim është konfirmuar edhe me numrin e personave të cilët janë rekrutuar dhe kanë shkuar në vatra në Siri. OJF që kanë qenë lëndë e analizës janë regjistruar dhe veprojnë me aktivitetet e tyre në këto rajone me rrezik të lartë.

Donacione/sponsorime të transferuara nga vendet me rrezik të lartë ose vende në të cilat ka konflikte dhe luftëra.

Analiza e bërë për punën financiare të OJF që kanë qenë lëndë e observimit tregon se të njëjtat financohen me mjetet e marra në bazë të donacioneve dhe projekteve nga personat fizikë dhe juridikë në territorin e së cilit janë realizuar sulme teroriste, vepronë organizata dhe grupe eksremisht radikale dhe terroriste ose kufizohen me shtete me konflikte ushtarake.

OJF nuk sigurojnë informacione për aktivitetet e tyre dhe transaksionet e kryera financiare në mënyrë në të cilën mund të verifikohet nga institucionet.

Është përcaktuar se për OJF që kanë qenë lëndë e analizës nuk ka informacione në dispozicion (psh. ueb faqe) për qëllimet dhe aktivitetin e tyre, mënyrën e financimit, strukturën pronësore dhe drejtuese, raporte vjetore etj. Shtesë ato nuk sigurojnë informacione për institucionet që të mund të verifikojnë nëse transaksionet e realizuara janë në pajtim me qëllimin e tyre.

Sipas analizës, nuk është konstatuar financim i dëshmuar i terrorizmit përmes OJF-ve në Maqedoninë e Veriut. **Për shumicën e OJF-ve rreziku është i vogël.** Mundësia e përfshirjes dhe abuzimit të OJF-ve për qëllime të FT-ve ekziston në kryerjen e veprimtarive të natyrës socio-humanitare, kulturore-arsimore dhe fetare të OJF-ve në ndërlidhje me realizimin e faktorëve të rrezikut. Në këtë kontekst, **rreziku i qenësishëm i FT për këto lloj të OJF-ve është i ulët deri në mesatar.**

Ndërveprimi i aktiviteteve të identifikuar dhe faktorëve të rrezikut identifikon organizatat qytetare që potencialisht mund të keqpërdoren për qëllime të FT. Gjegjësisht, me analizën e të dhënave cilësore është konstatuar se ekziston mundësia që OJF-të, veprimtaria e të cilave është e natyrës socialo-humanitare, kulturore-arsimore dhe/ose fetare të përfshihen dhe keqpërdoren për qëllime të FT në rastet kur plotësohet një nga faktorët e mësipërm të rrezikut.

Siç është dhënë në Raporti e FATF për rrezikun e keqpërdorimit të organizatave jofitimprurëse për qëllimet e financimit të terrorizmit³⁴ në të cilin janë definuar edhe tipologjitë, është vërejtur se rreziku nga FT është veçanërisht i kufizuar për OJF që sigurojnë shërbime pasi nuk ekzistojnë raste ose dyshime për FT midis OJF-të ekspresive.

Ekziston mundësi OJF veprimtaria e së cilave është e karakterit socio-humanitar, kulturoro-arsimor dhe religjioz të involvohen dhe keqpërdoren për qëllimet e FT në rastet kur është përmbushur ndonjë nga faktorët e rrezikut të elaboruar më lartë. **Si rrjedhojë 87% e OJF të cilat bëjnë pjesë në definimin e OJF të FATF kanë rrezik të ulët, ndërsa për rreth 13% është rreziku i ulët në të mesëm. Në këtë kontekst rreziku inherent nga FT për nëngrupin e OJF është i ulët në të mesëm.**

34 Raporti i FATF për rrezikun nga keqpërdorimi i rganizatave jofitimprurëse me qëllim të financimit të terrorizmit është në dispozicion: <https://www.fatf-gafi.org/documents/documents/risk-terrorist-abuse-non-profits.html>

Vlerësimi i rrezikut konkludon se rreziku i mundshëm i FT është i kufizuar në ato QJQ me karakter socio-humanitar, kulturoro-arsimor dhe fetar.

Për qëllime të Vlerësimit të Rrezikut të FT për QJF-të, u krye një anketë e shoqatave dhe fondacioneve për të siguruar të dhëna statistikisht të vlefshme për aktivitetet e organizatave³⁵. Organizatat religjioze dhe fetare janë anketuar me pyetësor të veçantë.³⁶ Në Vlerësimin e rrezikut nga FT për QJF janë analizuar konstatimet e anketave nga QJF për realizimin e kategorive të rrezikut. Segmenti i QJF në të cilin vlerësohet se potencialisht mund të manifestohet rreziku (13%) përfshin QJF sipas FATF të cilët kryejnë aktivitete të karakterit socio-humanitar, kulturoro-arsimor dhe religjioz, sigurojnë shërbime në rajonet e rrezikshme

35 Anketë për perceptimet për rreziqet e financimit të terrorizmit dhe efektiviteti i masave dhe veprimeve për parandalimin e tij ishte zbatuar në vitin 2019. Ishte selektuar ekzemplar statistikor relevant dhe janë grumbulluar përgjigje prej 379 organizatave qytetare, të cilat janë intervistuar përmes telefonit. Është siguruar shpërndarje gjeografike e balancuar e organizatave qytetare, duke përfshirë të anketuar prej të gjitha rajoneve në shtet. Duke e ndjekur gjendjen reale të popullatës së organizatave qytetare shumica e të anketuarve ishin shoqata qytetarësh, ndërsa janë përfshirë edhe organizata me focus dhe fushëveprim të ndryshëm programor.

36 *Hulumtim anketues i kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze: Në bashkëpunim me Komisionin për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze (KMBFGR) u zbatua pyetësor për perceptimet për rreziqet e financimit të terrorizmit dhe efektivitetin e masave dhe veprimeve për parandalimin e tij midis kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze. Pyetësorët anketues janë shpërndarë në formë letrë dhe përgjigjet janë siguruar nga 19 subjekte nga gjithsej 38 kisha të regjistruara, bashkësi fetare dhe grupe religjioze të evidentuara në regjistrin publik të KMBFGR.*

në vend sipas Vlerësimit nacional të rreziqeve (Rajone me rrezik të lartë nga terrorizmi: Shkup, Kumanovë, Tetovë dhe Gostivar, Raport i OJF, 2020). **Për të sqaruar, kjo nuk do të thotë se të gjitha OJF në këtë segment përballen me rrezik specifik, por se nëse rreziku manifestohet, pritet se ai do të manifestohet në këtë segment.**

Më tej, kjo pjesë e vlerësimit të rrezikut është fokusuar në rrezikun inherent që do të thotë rrezik që ekziston pa zbatimin e masave siç janë rregullativa ligjore dhe masat e brendshme të organizatave.

Vlersimi i rrezikut nga FT për OJF e vlerëson nivelin e efikasitetit të masave për zbutjen e rrezikut nga financimi i terrorizmit.

	Grup masash	Efikasiteti
1	Ligje dhe rregulla	Nivel i mesëm – i lartë
2	Masa të politikave dhe përfshirja e OJF	Nivel i lartë
3	Masa të vetërregullimit të OJF	I mesëm

ELABORIM:

Vlerësimi i rrezikut i identifikoi grupet ekzistuese të masave për zbutjen e rrezikut inherent siç janë ligjet dhe rregullat, politikat dhe masat për përfshirjen e OJF dhe masat ekzistuese të vetërregullimit të sektorit të OJF. Këto masa janë analizuar në mënyrë të detajuar dhe niveli i tyre i efikasitetit ishte vlerësuar siç është shfaqur në tabelën më lartë.

Elaborim: Si rrjedhojë, rreziku rezidual nga financimi i terrorizmit për OJF-të në Republikën e Maqedonisë së Veriut është „i ulët në të mesëm“.

ÇFARË DO TË THOTË KJO PËR ORGANIZATËN TIME

Është e rëndësishme që çdo organizatë jofitimprurëse të kuptojë se si standardet ndërkombëtare, legjislacioni kombëtar në lidhje PPP dhe FT dhe Vlerësimi i rrezikut nga FT për OJF-të ndikojnë në aktivitetet e saj legjitime. Kjo do ta lehtësojë komunikimin dhe funksionimin e organizatës suaj me institucionet, bankat dhe partnerët në një mënyrë që do të krijojë besim dhe do të mbrojë organizatën dhe njerëzit që punojnë në të.

Pa dallim nëse organizata juaj bën pjesë nën definimin e FATF për OJF, çdo organizatë e kujdesshme do të miratonte qasje të bazuar në rreziqe për t'i kuptuar rreziqet me të cilat mund të përballë OJF dhe të sjellë masa të drejtuara për zbutjen e rreziqeve. Ky nuk është proces i komplikuar, ndërsa vegla që është dhënë në pjesën në vijim do të ndihmojë në këtë pikëpamje.

Është e rëndësishme të kuptoni nëse organizata juaj bie nën përkufizimin e FATF të një OJF-je. Nëse po, kjo ndoshta do të thotë se rregulloret për PPP dhe FT të diskutuara në kapitujt e mëparshëm do të ndikojnë në organizatën tuaj më shumë se çdo organizatë tjetër. Kjo nuk do të thotë se organizata juaj po bën diçka të gabuar ose se është me rrezik të lartë. Thjesht tregon se puna e madhe që bëni për të ofruar mirëqenie publike dhe për të ndihmuar njerëzit është një aktivitet që mund të jetë më i prekshëm nga keqpërdorimi i mundshëm i financimit të terrorizmit dhe, në raste të rralla, nga pastrimi i parave. Kjo gjithashtu nuk do të thotë që ju duhet të keni frikë të vazhdoni të kryeni misionin tuaj dhe aktivitetet legjitime, por se duhet të jeni më të kujdesshëm dhe të mbronj organizatën tuaj nga çdo abuzim i mundshëm.

Për të mësuar nëse organizata juaj bën pjesë nën përkufizimin e FATF për OJF-të në Maqedoninë e Veriut, përgjigjuni pyetjeve të dhëna më poshtë. Nëse jeni OJF me seli në një vend tjetër, opsionet e dhëna në pyetjen e parë mund të jenë të aplikueshme varësisht kornizës rregullatorë për organizatat jofitimprurëse në vendin tuaj dhe mund të përfshijnë edhe organizatat joformale. Në këtë rast, mund të thirrëni në forma të ndryshme juridike në vendin tuaj.

Shënimet tuaja:

1	Organizata e juaj a është regjistruar si një prej subjekteve juridike në vijim?		
	Shoqatë	PO	JO
	Fondacion	PO	JO
	Kishë	PO	JO
	Bashkësi fetare	PO	JO
	Grup religjioz	PO	JO
	Kryqi i kuq	PO	JO
	Organizatë joqeveritare ndërkombëtare	PO	JO
2	Organizata e juaj u siguron çfarëdo shërbimesh/ndihmë direkte (përfshirë edhe financiare) shfrytëzuesve të cilët janë persona fizikë ose grup i personave fizikë?	PO	JO

3	Organizata juaj a siguron mbështetje dhe a punon për interesin më të gjerë publik dhe bashkësinë dhe nuk është e kufizuar vetëm që t'ju shërbejë anëtarëve të vet?	PO	JO
4	Organizata juaj kryesisht grumbullon mjete dhe i përdorë për qëllime bamirësie, fetare, kulturore, arsimore, sociale apo vëllazërore?	PO	JO

Nëse përgjigjeni me "PO" në të gjitha apo në shumicën e pyetjeve, atëherë organizata juaj bën pjesë nën definimin e FATF për OJF.


PËR SHEMBULL:

Nëse jeni një fondacion për mbledhjen e fondeve për të ofruar kurse edukimi për të rinjtë në zonat rurale, atëherë organizata juaj është një OJF sipas FATF. Në mënyrë të ngjashme, nëse jeni një shoqatë që ofron ndihma humanitare (veshje, sende higjienike, donacione, etj.) për persona që marrin asistencë sociale, do të ishit gjithashtu një OJF, që bie nën përkufizimin e FATF. Nga ana tjetër, nëse jeni një klub sportiv i regjistruar si një shoqatë që zakonisht ofron kurse basketbolli për anëtarët e vet që paguajnë një tarifë anëtarësimi, atëherë ndoshta nuk jeni një OJF që bie nën përkufizimin e FATF.

V.

MBRONI ORGANIZATËN TUAJ

Për ta mbrojtur organizatën tuaj nga keqpërdorimi potencial për financimin e terrorizmit dhe larjen e parave, zbatoni masa parandaluese të brendshme të cilat përbëhen nga hapat vijues:



Dokumentoni konstatimet dhe planin për veprim nga ky proces dhe shtroni raport për trupat drejtues për progresin.



Rekomandim:

Shfrytëzoni procesin e propozuar për vlerësim të përgjithshëm të rrezikut të organizatës tuaj, me ç'rast rreziqet prej larjes së parave dhe financimit të terrorizmit do të jenë pjesë përbërse prej të gjitha rreziqeve të tjera

me të cilat mund të përbal-
let organizata juaj. Kjo do ta
racionalizonte menaxhimin
me rreziqet të organizatës
tuaj dhe do t'ju ndihmojë në
mënyrë efektive t'i përdorni
resurset tuaja.

HAPA 1

Identifikoni dhe kuptoni rreziqet potenciale për ju

Shumë pak organizata në vendin tonë mendojnë se organizata e tyre është në rrezik të keqpërdorimit të mundshëm për larje parash dhe financim të terrorizmit, sepse besojnë se ne po veprojmë me mirëbesim për të përmbushur misionet tona dhe për t'i shërbyer komuniteteve dhe klientëve tanë. Megjithatë, ne mund të ekspozohemi ndaj një lloji rreziku thjesht për shkak të llojit të punës që bëjmë, transaksioneve që bëjmë ose vendndodhjes gjeografike të organizatës sonë ose aktiviteteve tona. Për shembull, nëse mbledhni kontribute në para ose paguani me para në dorë, jeni më të rrezikuar në krahasim me organizatat që kryejnë të gjitha transaksionet me transfertë bankare. Ose, nëse aktivitetet tuaja janë në zona gjeografike që janë më të ekspozuara ndaj aktiviteteve

të mundshme terroriste, atëherë organizata është në rrezik më të madh në krahasim me një organizatë të ngjashme të vendosur në zona ku nuk ka aktivitete të mundshme terrorist. Prandaj, identifikimi dhe kuptimi i rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozohet organizata juaj është hapi i parë për të mbrojtur në mënyrë efektive organizatën tuaj. Rreziku nuk do të thotë automatikisht diçka e keqe, është një pjesë normale e jetës sonë të përditshme private dhe profesionale. Për shembull, çdo ditë kur dalim në rrugë jemi të ekspozuar ndaj rreziqeve të sigurisë në trafik si këmbësorë ose si shoferë. Ne jemi të vetëdijshëm për këto rreziqe dhe marrim masa për t'u mbrojtur. Rreziqet bëhen negative dhe potencialisht të rrezikshme vetëm kur injorohen. Rreziqet që lidhen me PPP dhe FT nuk janë të njëjta me të gjitha rreziqet e tjera që përjetojmë në jetë.

Në këtë drejtim, kur flasim për rrezik në këtë kontekst, flasim për rrezikun "inherent", pra rrezikun që ekziston për shkak të natyrës së punës sonë si organizatë jofitimprurëse. Ai nuk përfshin masat që marrim (politika, procedura, etj.) për të mbrojtur organizatat tona dhe për të zbutur rreziqet.

Për të ndihmuar në identifikimin e rreziqeve të mundshme në organizatën tuaj, mund të përdorni mjetin e propozuar që kemi krijuar duke marrë parasysh specifikat e aktiviteteve dhe transaksioneve (marrëdhëniet e transaksionit) në OJF. Mjeti gjithashtu ndihmon për të kuptuar se cilat nga këto rreziqe të mundshme janë më të rëndësishme për organizatën tuaj, në mënyrë që të mund të fokusoni burimet tuaja të kufizuara në zbutjen e këtyre rreziqeve. Vegla është disajnuar për t'u shërbyer organizatave më të mëdha si dhe OJF-ve të vogla dhe mund të personalizohet dhe thjeshtohet në përputhje me rrethanat.

Ne ju rekomandojmë të krijoni një grup pune në organizatën tuaj për këtë detyrë, i cili do të përbëhet nga përfaqësues të organizatës suaj, duke përfshirë: anëtarë të organeve drejtuese, njerëz në pozita drejtuese, njerëz në pozita të financave dhe administratës, njerëz përgjegjës për mbledhjen e fondeve, njerëzit për zbatimin e programit, veçanërisht ata që janë në komunikim të drejtpërdrejtë me përdoruesit përfundimtarë. Meqenëse shumica e OJQ-ve në Maqedoninë e Veriut janë organizata të vogla, do të jetë e lehtë të përfshihen të gjithë anëtarët e ekipit kryesor. Mund të jetë praktike të përfshini vlerësimin e rrezikut në seminarin tuaj të ardhshëm të planifikimit vjetor ose në procesin e planifikimit strategjik, dhe pastaj ta rishikoni periodikisht atë.

Rreziku për organizatën tuaj mund të identifikohet sipas aktiviteteve që i zbaton organizata ose sipas llojeve të transaksioneve (financiare dhe jofinanciare) që i bën.

Vegël ndihmëse për identifikimin e rrezikut potencial

Rreziqe sipas aktiviteteve

Anëtarësia dhe menaxhimi

Shërbime për shfrytëzuesit (arsim, ndihmë juridike, akomodim dhe transport, mbështetje psikologjike – sociale, etj.)

Ndihmë financiare për shfrytëzuesit dhe grupet e targetuara (bursa, kontribute vullnetare dhe ndihmë tjetër humanitare, donacionet, etj.)

Aktivitete dhe ngjarje promovuese

Grumbullimi i mjeteve (grante, donacione, sponsorime, etj.)

Bashkëpunim me organizata të tjera dhe palë të involvuara

Furnizime

Rreziqe sipas transaksioneve (financiare dhe jofinanciare)

Pagesa me para në duar

Kripto valuta

Transaksione financiare prej/deri tek vendet/jurisdiksonet me rrezik të lartë dhe oaza tatimore

Marrja e donacioneve dhe dhuratave të tjera

Marrje e sponsorimeve

Sigurimi i donacioneve / ndihmë humanitare

Resurse njerëzore (të punësuar, të punësuar me orar të shkurtuar dhe vullnetarë)

Mbulimi i shpenzimeve për shfrytëzuesit

Shfrytëzimi i hapësirave dhe pajisjeve

Punë jashtë vendit (vendje me rrezik të lartë dhe oaza tatimore)

Rreziqet në masë të madhe do të dallojnë midis organizatave, ato do të jenë specifike për organizatën tuaj, prandaj shmangni kopjimin e rreziqeve të cilat janë indentifikuar dhe vlerësuar prej organizatave të tjera.

Diskutoni çdo lloj aktiviteti dhe identifikoni skenarët e rrezikshëm që mund të lindin në lidhje me atë aktivitet ose transaksion të veçantë. Kapërceni ato që mund të mos jenë të rëndësishme për organizatën tuaj (për shembull, nuk keni transaksione me kriptomonedha, etj.). Për të përdorur këtë proces për vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut, merrni parasysh se cilat rreziqe të tjera mund të përballeni në lidhje me aktivitetet dhe transaksionet e mësipërme. Mos ngurroni të shtoni aktivitete ose transaksione të tjera nëse ato janë të rëndësishme për organizatën tuaj.

Vetëm për qëllime ilustruese, ju mund të identifikoni se bursat në para që u jepni disa prej përdoruesve tuaj mund të keqpërdoren për FT. Për të marrë parasysh gamën më të gjerë të rreziqeve, bursat mund të abuzohen edhe nga persona që pretendojnë në mënyrë të rreme se i përkasin kategorive të cenueshme socio-ekonomike. Për më tepër, mund të imagjinoni se disa nga vullnetarët tuaj abuzuan me organizatën për të promovuar ideologji radikale e kështu me radhë. Në një kontekst më të gjerë, vullnetarët mund të përdorin komunikim të papërshtatshëm me klientët tuaj ose t'i trajtojnë ata në mënyrë të vrazhdë, duke rrezikuar reputacionin e organizatës; përdoruesit mund të lëndohen edhe gjatë punës me vullnetarë, etj. Në këtë fazë, thjesht rendisni të gjitha aktivitetet dhe transaksionet e mundshme që keni në organizatën tuaj që mund të krijojnë një rrezik. Përsëri, ne nuk e konsiderojmë atë që bëjmë për ta parandaluar këtë (siç janë politikat dhe procedurat e brendshme).

HAPA 2 | Bëni vlerësimin e rreziqeve

Pasi i keni theksuar të gjithë skenarët e mundshëm (sipas aktiviteteve dhe/apo transaksionit) të cilat mund të çojnë drejt rreziqeve lidhur me PPP dhe FT, vlerësoni secilin prej tyre duke përdorur numra (psh. 1 – 5) në bazë të mundësisë ky rrezik të ndodhë dhe pasojat potenciale. Diskutoni faktorët vijues:

Të vlerësohet probabiliteti – Sa është e mundur ky skenar të ndodhë në bazë të përvojës tonë paraprake, sa ky aktivitet është dominues në organizatën tonë, vlerësimin nacional të rreziqeve për OJF etj.? Sa shpesh praktikohen këto lloje të aktiviteteve ose transaksioneve në organizatën tonë (në periudhë prej 12-24 muajsh)?

Të vlerësohen pasojat potenciale – Sa serioz do të ishte ndikimi dhe pasojat për misionin tonë, shfrytëzuesit ose donatorët tanë, vendi dhe organizata (juridike, sipas imazhit, financiare etj.) nëse ndodhë skenari konkret?

Nëse jeni një organizatë e madhe me degë në vende dhe zona gjeografike të ndryshme, vlerësimi mund të ndryshojë dhe për këtë arsye vlerësojini ato veçmas. Produkti i vlerësimeve për të dy faktorët (probabiliteti x pasojë) do t'ju japë vlerësimin e rrezikut inherent. Disa skenarë të mundshëm mund të marrin një rezultat prej 2 (p.sh. 2 për probabilitetin x 1 për pasojat) që do të nënkuptonte rrezik të ulët inherent, ndërsa të tjerët mund të kenë një rezultat prej 20 (p.sh. 4 për probabilitetin x 5 për pasojat) që do të tregonte një nivel

të lartë të qenësishëm rreziku. Disa mund ta konsiderojnë atë një rrezik mesatar. Për momentin, rezultatet 1-6 do të konsideroheshin me rrezik të ulët, 7-14 do të konsideroheshin me rrezik të mesëm, ndërsa rezultatet 15-25 do të tregonin rrezik të lartë.

Në bazë të vlerësimit, do të mund të përpiloni listë të rreziqeve të cilat do të ishin prioritet për organizatën tuaj dhe në të cilat do të duhej fillimisht t'u kushtoni shumë vëmendje. Në hapat vijues, do të duhet të ndani kohë dhe resurse që të përqendroheni në fushat me rrezik të lartë inherent, ndërsa gjithashtu shqyrtoni edhe disa prej rreziqeve inherente të mesme. Në këtë fazë nuk duhet shtesë të përballeni me fushat me rreziqe të ulëta inherente.

Që të ilustrohet logjika, pason shembull i shpikur për atë se si mund të duket identifikimi i rrezikut organizues i OJF. Në procesin e definimit të rrezikut për organizatën tuaj, merrni parasysh faktorët e rrezikut të definuar në Vlerësimin e rreziqeve nga FT për OJF në Maqdoninë e Veriut të prezentuara në faqet paraprake.

PËR SHEMBULL

Organizata „Helping Hand” siguron ndihmë humanitare për njerëzit të cilët kanë nevojë. Ky është programi kryesor i organizimit që ndodhë në Kumanovë, që është fushë rreziku në shtet. Gjatë vlerësimit të rrezikut, organizata i definoi 3 rreziqet më të mëdha:

Rreziku 1

Mund të sigurohet ndihmë e drejtpërdrejtë e personave lidhur me terrorizmin

Elaborime dhe konstatime faktike: Sigurimi i ndihmës financiare dhe materiale të drejtpërdrejtë qytetarëve të cilëve u nevojitet funksion kryesor i organizatës dhe ajo rregullisht u sigurohet një numri të konsiderueshëm të shfrytëzuesve varësisht madhësisë së bashkësisë. Në praktikë, njerëzit e bashkësisë i drejtohen organizatës që të marrin ndihmë e cila sigurohet në bazë të disa kriterëve të caktuara lidhur me pozitën e tyre socio-ekonomike. Pjesa më e madhe e ndihmës paguhet në Kumanovë dhe në fshatat përreth.

Meqë ky aktivitet është më i rëndësishëm për misionin e organizatës, keqpërdorimin potencial nga shfrytëzuesit për mbështetjen e terrorizmit mund të çojë drejt dëmit të konsiderueshëm të prestigjit, mund të çojë drejt mbylljes së programit që në fund do t'i privojë personat e cënueshëm nga mbështetja e rëndësishme e drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë, skenari ka marrë vlerësim të lartë dhe lidhur me mundësinë dhe lidhur me ndikimin. „Helping Hand“ vendosi tërësisht t'i rishikojë politikat e veta për shpërndarjen e ndihmës humanitare.

Rreziku 2

Hapësirat e organizatës mund të keqpërdoren për mbështetje logjistike të terrorizmit

Elaborim dhe konstatime faktike: „Helping Hand“ka marrë donacion prej disa kompjuterëve dhe printerëve nga kompania lokale. Meqë organizata nuk ka nevojë rregullisht ta përdorë këtë pajisje, ka vendosur një pjesë e zyrës të jetë hapësirë e hapur për bashkësinë në të cilin individë ose organizata do të mund ta përdorin pajisjen. Shpesh njerëzite përdorin këtë mundësi që të shtypin material të ndryshme si për shembull broshura. Meqë ky shërbim paraqitet shpesh, ajo do të ishte

mundësi e madhe relative (edhe pse më pak se rreziku 1) dhe ndikim mesatar deri në të lartë pasi kjo nuk është shërbim me rëndësi vitale për shfrytëzuesit, por megjithatë mund të paraqesë rrezik për prestigjin dhe rrezik financiar për donatorët korporativë, nëse konsiderohet se janë të përfshirë në keqpërdorimin potencial. Prandaj, organizata vendosi të krijojë rregulla dhe kushte nën të cilat mund të përdoret pajisja meqë ky skenar ishte vlerësuar si rrezik i mesëm.

Rreziku 3

*Imazhi i
organizatës në
bashkësi mund
të keqpërdoret
për grumbullimin
e mjeteve nga
persona të tretë
me prezetim të
rrejshëm*

Elaborim dhe konstatime faktike: Organizata grumbullon mjete në bashkësi duke përdorur qasje nga dera në derë. Pranohen donacione të vogla në të holla nga qytetarë të cilët janë evidentuar në mënyrë përkatëse. Potencialisht, një person i tretë mund ta shfrytëzojë emrin e tyre që të grumbullojë donacione prej qytetarëve.

Në praktikë ky rrezik ishte i vogël pasi qytetarët lokalë i njohin vullnetarët e tyre. Megjithatë, grupi vendosë t'i shqyrtojë masat e zbutjes edhe të këtij rreziku pasi pasojat potenciale për angazhimet e tyre të ardhshme për grumbullimin lokal të mjeteve dhe besimit midis qytetarëve lokalë mund të çrregullohen.

Lista e kontrolleve



Organizata e juaj a mund t'i japë tre rreziqet e para prioritare potenciale nga LP/FT gjatë aktiviteteve dhe/ apo transaksioneve të organizatës?

HAPA 3 | Definoni masat zbutëse

Pasi t'i definoni rreziqet prioritare, duhet të krijoni masa të cilat do ta parandalojnë dhe zbusin realizimin e tyre në jetën reale. Logjika e qasjes së bazuar në rreziqe është si vijon: atje ku ka rreziqe më të larta, duhet të ndërmerren masa të përforcuara dhe më detajuese për menaxhimin dhe zbutjen e këtyre rreziqeve, madje edhe nëse jeni organizatë e vogël. Qasjet drejt rreziqeve të identifikuara prioritare mund të ndryshojnë dhe t'i përfshijnë masat vijuese: Shmangien (ndalimin e aktivitetit të rrezikshëm); zvoglimin (vendosjen e njëfarë ndryshimi, ashtu që rreziku është më pak e mundur të ndodhë); zbutjen (aktivitete për minimizimin e ndikimit të rrezikut nëse ndodhë); sigurim (ndërmarrjen e masave që të merrni kompensim nëse paraqitet rrezik); pranimi (vendim i vetëdijshëm se rreziku nuk mund të zbutet, por se megjithatë do të vazhdoni, zakonisht pasi bëhet fjalë për aktivitet i cili është kritik për misionin). Duke e ndjekur njërin prej shembujve të lartpërmendur, organizata mund të vendosë se do të ndalojë t'u oforjë anëtarëve të bashkësisë lokale që t'i përdorin kompjuterët dhe pajisjen (qasjen e shmangies).

Megjithatë, ajo gjithashtu mund të vendosë se bëhet fjalë për resurs thelbësor për bashkësinë lokale, me ç'rast mund të përdorë qasje për zvogëlim dhe t'i kufizojë mënyrat dhe personat të cilëve u lejohet ta përdorin pajisjen ose të përdorë qasje lehtësuese përmes përgatitjes së rregullave për përdorimin e pajisjeve.

Prioritet duhet t'u jepen skenarëve me rrezik më të madh dhe në këtë rast masat të cilat i ndërmarrin OJF duhet të jenë më të gjerë lidhur me përfshirjen, shkallën, shpeshtimin dhe intensitetin. Për shembull, masat për zbutjen e rreziqeve më të mëdha duhet


të përfshijnë më shumë nive të kontrolleve të brendshme dhe kontrollin dhe mund të kërkojnë procedura detajuese të cilat do të ndiqen rregullisht. Në kundërshtim me këtë, rreziqet e ulëta nuk do të kërkojnë masa urgjente dhe intensive dhe për shembull mund të mbulohen me aktivitete informative ose material për personelin e OJF-së.

Është e rëndësishme masat për parandalim dhe zbutje që do t'i krijojnë dhe ndërmarrë organizata juaj të jenë proporcionale me madhësinë dhe kapacitetin e organizatës tuaj. Kjo do ta përforcojë efikasitetin e tyre pasi organizata do të ketë kapacitet dhe resurse t'i zbatojë masat e identifikuar.

Në vazhdim janë dhënë masa për zbutje për shembullin tonë:

PËR SHEMBULL

Pas identifikimit të rreziqeve organizative, „Helping hand” krijoi masa zbutëse si pjesë e planit vjetor organizativ që ishte miratuar nga Kuvendi i organizatës.



Rreziku 1

*Mund të sigurohet
ndihmë e
drejtpërdrejtë për
persona lidhur me
terrorizmin*

Masa zbutëse

1. Rishikoni dhe azhurnoni procedurat që të siguron përgjegjësi të qartë që personeli të kontrollojë nëse pranuesit potencial të ndihmës humanitare i përmbushin kriteret.
2. Përgatisni listë për kontroll për secilin prej kriterëve që duhet t'i përmbushë personeli i emëruar përgjegjës (përfshini kontrollin e kryqëzuar të emrave të pranuesit potencial lidhur me listat dhe sanksionet në dispozicion).
3. Krijoni mekanizëm shtesë për kontroll të brendshëm që do të mundësojë më shumë se një i punësuar të kyçet në këtë proces (siç janë: miratimi i formularit; kontroll shtesë të pranuesit etj.)
4. Vendosni deklaratë me shkrim në të cilën pranuesi i ndihmës do të deklarojë se ndihma humanitare do të përdoret vetëm për nevojat e tij kryesore dhe se pranuesi nuk shtë i përfshirë në terrorizëm dhe financimin e terrorizmit. Deklarata duhet të nënshkruhet para se të sigurohet ndihma.
5. Mbani kontakte të rregullta me shfrytëzuesit dhe anëtarët e bashkësisë që të siguroheni se nevojat e tyre përmbushen përmes strukturës institucionale. Kjo, gjithashtu, do t'i mbrojë shfrytëzuesit nga keqpërdorimi i grupeve joligjore.

Rreziku 2

*Hapësirat e
organizatës mund
të keqpërdoren
për mbështetje
logjistike të
terrorizmit*

Masa zbutëse

1. Vendosni procedure për paraqitje për përdorimin e hapësirave dhe pajisjes në të cilën kërkuesi do t'i përshkruajë aktivitetet për të cilat do ta përdorë këtë shërbim dhe do të sigurojë informacione kryesore për organizatën/ qytetarin.
2. Në procesin e shqyrtimit të formularit për paraqitje, kontrollo-ni të dhënat e dhëna duke përdorur burime të disponueshme të informacioneve.
3. Vendosni deklaratë me shkrim në të cilën pranuesi i ndihmës do të deklarojë se nuk është i përfshirë në terrorizëm dhe që duhet të nënshkruhet para se të sigurohet mundësia për shfrytëzimin e hapësirave.
4. Kërkoni ekzemplar prej materialeve promovuese që do të përgatiten në hapësirat nga shfrytëzuesit e shërbimeve
5. U mundësoni t'i nxisni donatorët të paraqesin në organizatë raste të prezentimit të rrejshëm.

Rreziku 3

*Imazhi i
organizatës në
bashkësi mund
të keqpërdoret
për grumbullimin
e mjeteve prej
personave të tretë
me prezentim të
rrejshëm*

Masa zbutëse

1. Shtypni shenjat identifikuese me emrat për mbledhësit e mjeteve me vulën e organizatës të cilat do t'i mbajnë në një vend të dukshëm.
2. Jepni pëlqim me shkrim për mbledhësit e mjeteve për të kërkuar donacione në emër të organizatës.
3. Kur është e mundur, organizoni mbledhësit e mjeteve që të mbledhin donacione në çifte dhe në bazë të parimit të rotacionit, me qëllim që të parandalohet sjellja e papërshtatshme.
4. Në ueb faqen e organizatës publikoni informacione për mbledhësit e mjeteve, duke e përfshirë edhe përdorimin e kartelave për identifikim.
5. Mundësojuni dhe stimuloni donatorët të denoncojnë në organizatë rastet e prezentimit të rrejshëm.

Siç është e dukshme nga shembulli, masat mbrojtëse nga keqpërdorimet ndryshojnë nga rasti në rast dhe do të varen prej karakteristikave të aktiviteteve të OJF. Në faqet vijuese do të gjeni udhëzime për temat kryesore të cilat është e rëndësishme të merren parasysh gjatë krijimit të masave tuaja personale për parandalim dhe zbutje.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM DHE ZBUTJE

MENAXHIM I MIRË DEMOKRATIK

Praktika e qeverisjes demokratike dhe të mirë është një parakusht i rëndësishëm për çdo rrezik me të cilin mund të përballen OJF-të. Struktura e qeverisjes dhe procesi i vendimmarrjes duhet të përcaktohen në dokumentet statutore të OJF-ve dhe të zbatohen plotësisht në praktikë. Të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjitha organeve organizative duhet të përcaktohen me shkrim: menaxheriale, ekzekutive dhe mbikëqyrëse. Kufizimi i fuqisë diskrecionale për të marrë vendime (siç është një ndarje e qartë e pushteteve dhe pushteteve ekzekutive) dhe ngritja e një sistemi për të parandaluar konfliktet e interesit do t'i lejojë OJF-të të parandalojnë çdo sjellje të keqe të rëndësishme. Në praktikë, madje edhe nëse jeni organizatë e vogël, parimi kryesor për sjelljen e vendimeve në të gjitha funksionet tuaja kryesore është se së paku dy persona duhet të jenë të informuar dhe të përfshirë në sjelljen e vendimeve për projektet dhe aktivitetet e organizatave, njerëzit të cilët i angazhon organizata, transaksionet (juridike dhe financiare) që i kryejnë organizatat etj.

Struktura e menaxhimit të mirë në organizatën tuaj duhet të sigurohet se puna që e bëni:


- a** është në pajtim me misionin tuaj,
- b** është në pajtim me legjislativin dhe nuk angazhohet në aktivitete kriminale,
- c** siguron se të gjithë anëtarët dhe të punësuarit veprojnë me integritet dhe e zbusin konfliktin e interesave,
- ç** e mbron pavarësinë nga ndikimet e jashtme.

Për shkak se abuzimet mund të vijnë nga vetë organizata, një sistem i përcaktuar i menaxhimit të organizatës është masa më e rëndësishme zbutëse. Të gjitha pozitat në organizatë duhet të mbahen përgjegjëse për sjelljen e tyre ligjore dhe organizata duhet të ketë krijuar mekanizma për të siguruar llogaridhënien dhe pajtueshmërinë ligjore siç janë: përgjegjësia e qartë për punonjësit që të ndjekin rregulloret brenda fushëveprimit të tyre të punës; ngritja e kapaciteteve të brendshme dhe shkëmbimi i njohurive; kontrolli i brendshëm i pajtueshmërisë; monitorimi i ndryshimeve rregullatore; konsultime me OJF dhe/ose profesionistë me ekspertizë ligjore, etj.

Mundësimi i pavarësisë së organizatës nga ndikimi i jashtëm është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes së mirë, që ka një rol për të luajtur në parandalimin e abuzimeve për qëllime të financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave. Në këtë drejtim, është thelbësore të njihni anëtarët tuaj, dhe veçanërisht anëtarët e organeve të organizatës suaj që kanë akses në burimet tuaja dhe marrin vendime për programin. Kjo nuk do të thotë që ju i

njihni ata personalisht, por sigurohuni që të mos jenë pjesë e një grupi terrorist ose të mos jenë të përfshirë në një grup kriminal. Nëse një anëtar i organizatës suaj është një person i ekspozuar politikisht, sigurohuni që funksioni i tij/saj politik të mos ndikojë në vendimmarrjen e organizatës, duke përfshirë mbledhjen e fondeve dhe përdorimin e burimeve të organizatës.

Gjatë punës së organizatës suaj është e pashmangshme që ju të bëni gabime në menaxhimin e financave, duke shkelur pa dashje një detyrim ligjor për shkak të mungesës së njohurive, partneritet me subjekte që janë treguar të pabesueshëm etj. Është e rëndësishme që sistemi juaj i menaxhimit të përfshijë gjithashtu politika dhe procedura për mënyrën se si organizata do të veprojë për të zgjidhur çështjen, për të ndërmarrë veprime korrigjuese dhe për të parandaluar sjelljen e keqe në të ardhmen.



Lista për verifikim

☐	Organizata juaj a ka ndarje të qartë midis funksionit ekzekutiv dhe joekzekutiv të vendimmarrjes dhe nëse e zbutë konfliktin e interesave?
☐	Organizata juaj a i ka të paktën dy persona të përfshirë në vendimet kryesore siç janë programet, projektet dhe aktivitetet e organizatës dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare?
☐	Organizata juaj a ndërmerr hapa që të sigurohet se projektet dhe aktivitetet e juaja janë në pajtim me misionin?
☐	Organizata a ndërmerr hapa për mbrojtjen e pavarësisë së vet dhe ndikimit të jashtëm?
☐	Organizata juaj a ka plane dhe procedura të njëpasnjëshme kur identifikohen gabime dhe sjellje jopërkatëse?

MËSONI PARIMET TUAJA – KONTROLL PARAPRAK

Opinionit dhe ata që dhurojnë për OJF-të duhet të kenë besim se paratë e dhuruara përdoren për qëllime legjitime dhe se ato arrijnë tek shfrytëzuesit e synuar. Natyra filantropike dhe vullnetare e OJF-ve çon në një rrjet të gjerë donatorësh, partnerësh dhe shfrytëzuesish me të cilët OJF-të kanë transaksione. E thënë thjesht, financimi i terrorizmit është i lidhur me përdorimin e mjeteve për aktivitete terroriste, dhe pastrimi i parave është maskimi i parave të përfituara përmes aktiviteteve të paligjshme. Prandaj,

OJF-të duhet të kenë besim të arsyeshëm për origjinën e mjeteve që marrin dhe përdorimin përfundimtar të mjeteve financiare, mallrave dhe mjeteve që ua ofrojnë të tjerëve.

Për të mbrojtur organizatën tuaj, duhet të praktikohet paraprakisht shqyrtimi i atyre individëve dhe organizatave të cilëve OJF-ja juaj u ofron para, nga të cilët merr para ose me të cilët punon ngushtë. Kur organizata juaj u jep para partnerëve dhe shfrytëzuesve (veçanërisht shuma të mëdha parash ose në situata me rrezik të lartë), sigurohuni që të kryhet monitorimi i duhur. Kjo do të thotë që OJF-ja duhet të kontrollojë nëse mjetet ose pronat e saj arrijnë në destinacionet e tyre përkatëse dhe të përdoren siç synohet nga OJF-ja.

Sigurohuni që masat të cilat i ndërmerri të jenë të arsyeshme.

Trupat kontrollues të organizatës duhet të vlerësojnë çfarë është e arsyeshme për organizatën tuaj duke e marrë parasysh rrezikun dhe natyrën e aktivitetit.

Masat e arsyeshme duhet të jenë përkatëse me madhësinë e organizatës tuaj dhe vëllimin e aktiviteteve dhe **duhet të mund t'i zbatojnë me resurset ekzistuese të organizatës.**

Midis tjerash, resurset ekzistuese³⁷ i theksojnë parimet kryesore vijuese të kontrollit paraprak që duhet t'i ndjekin OJF-të:

- Identifikoni** – sigurohuni se me kë keni të bëni (donatorë, shfrytëzues dhe partnerë)
- Kontrolloni** – kur është e arsyeshme dhe kur rreziqet janë të larta, kontrolloni identitetet duke përdorur burime në dispozicion

Sipas njohurive dhe mundësive tuaja, OJF duhet të zbatojnë masa që të sigurohen se është e përshtatshme dhe legale të komunikojnë me persona fizikë dhe juridikë, veçanërisht në nivel të transaksionit dhe aktivitetit. OJF duhet t'i njohin donatorët e tyre, shfrytëzuesit dhe partnerët. Kërkesa dhe pritshmëri të ngjashme ka edhe për sektorët e tjerë. Për shembull, bankat duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm që t'i njohin klientët e tyre.

Shënimet tuaja:

37 Shikoni: Drejtoria për luftë kundër larjes së parave (Barbados, 2019), Drjetime për luftë kundër financimit të terrorizmit për organizata bamirësie dhe jofitimprurëse [onlajn] dhe Komision për organizata bamirësie për Anglinë dhe Uellsin (2011), Një paketë veglash për harmonizim: Mbrojtja e organizatave bamirëse nga shkaktimi i dëmit Kapituj 2: Kontroll paraprak, monitorimi dhe kontrolli i përdorimit final të mjeteve për qëllime bamirësie: rezyme [onlajn].

NJOFTONI DONATORIN TUAJ

OJF më së shumti mbështeten në mbështetjen e donatorëve. Me qëllim që ta mbron organizatën tuaj nga PP dhe FT, pritet ta dini, të paktën në kuptimin e gjerë, burimin e parave që jepen (grante, sponsorime nga një kompani e caktuar, donacione në të holla prej individëve etj.). Kjo nuk do të thotë se çdo donacion duhet të vihet në pikëpyetje dhe se duhet të grumbulloni shumë detaje personale dhe të tjera për çdo donator të mëvetësishëm. Praktika duhet të lidhet me vlerësimin tuaj të rreziqeve dhe veçanërisht, kur OJF-së tuaj i sigurohen shuma të rëndësishme, duhet të ndërmerreni hapa të arsyeshëm të cilët janë përkatëse për rreziqet e identifikuara që t'i njoftoni donatorët.³⁸

Drejtimit, këshillat dhe shembujt vijues do t'ju ndihmojnë në këtë proces:

- Sigurohuni se është përkatëse të merren mjete finansiare nga ai donator konkret.
- Sipas njohurive tuaja, kontrolloni burimin e mjeteve.
- Sigurohuni që kushtet lidhur me donacionin të jenë përkatëse dhe të mund të pranohen.

38 Source: Anti-Money Laundering Authority (Barbados, 2019), Combating Terrorist Financing Guideline for Charities and Non-Profit Organizations [online]. Available from: <https://barbadosfiu.gov.bb/wp-content/uploads/2020/06/Combating-Terrorist-Financing-Guideline-for-Charities-and-Non-Profit-Organizations-December-2019.pdf>

Ja disa situata dhe shembuj me flamur të kuq që tregojnë për kujdes:



Ndonjë kompani dëshiron t'i japë donacion OJF-së tuaj për ndonjë projekt të caktuar. Ajo në mënyrë joformale kumton se kusht për marrjen e donacionit është shërbimet që janë të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve projektuese (të cilat duhet të financohen nga donacioni) të furnizohen nga një degë e caktuar. Përveç përplasje interesash dhe parime etike, kjo mund të jetë mundësi për fshehjen e tatimit ose larje potenciale e parave. Në parim, shmangni pranimin e donacioneve ku donatori jep emra të personave/personave juridikë të cilët duhet t'i angazhoni, të kontraktoni nën marrëveshje ose të siguronin nën grant. Kjo nuk vlen nëse donatori e kushtëzon donacionin në kuptimin e karakteristikave specifike siç janë ofrimi i trajtimit të autorizuar për angazhimin e personave nga grupet e cënueshme, dakordimi i nën-marrëveshjes me kompani me disa standarde ekologjike, sigurimi i nëngrantit ose sigurimi i donacioneve për ndonjë qëllim specifik ose nëse ju i keni dhënë pranuesit në propozim-projektin tuaj, etj.



Ndojë organizatë dëshiron të bëjë një donacion në emër të një donatori që dëshiron të mbetet anonim. Donatorët ndonjëherë mund të kërkojnë të mbeten



anonim për një sërë arsyes (për shembull, shpallja publike e dhurimit të tyre mund të ndikojë në opinionin publik ose të zbulojë informacione për vlerat e tyre lidhur me identitetin, etj.). Megjithatë, është praktikë e zakonshme që dhuruesi të jetë i njohur për marrësin e donacionit (OJF) por jo për publikun. Rrjedhimisht, në këtë rast OJF-ja juaj duhet të kontrollojë reputacionin e organizatës që vepron në emër të donatorit dhe të shqyrtojë mundësinë që emri i donatorit të jetë i njohur për menaxhmentin tuaj, por jo për publikun.

Në rastin e mbledhjes publike të fondeve nëpërmjet përdorimit të kutive të donacioneve dhe metodave të ngjashme të mbledhjes së fondeve, donatorët individualë dhe shumat e dhuruara nuk mund të ndiqen. Në këtë rast OJF-ja duhet të dokumentojë procesin. Në fund të procesit të mbledhjes së fondeve, formoni një komitet prej 2-3 përfaqësuesish nga organizata juaj, të cilët do të numërojnë shumën, do të shkruajnë një raport dhe do t'i transferojnë paratë në llogarinë bankare të OJF-së duke vënë në dukje se fondet janë nga kutitë e donacioneve.



Një organizatë dëshiron të bëjë donacion. Një pjesë më e vogël e shumës do të jetë për OJF-në tuaj, ndërsa pjesa e mbetur duhet të transferohet te organizatat jashtë shtetit. OJF-ja juaj duhet ta analizojë me kujdes këtë situatë pasi është një flamur i kuq për larje parash ose fshehje të origjinës. Sigurohuni që t'i siguronit të gjitha detajet dhe shpjegimin nga donatori i mundshëm. Mendoni se si ky aktivitet lidhet dhe do të përfitojë nga misioni juaj.

Donacione prej vendeve me rrezik të lartë dhe vende që konsiderohen si parajsë tatimore. Të jeni veçanërisht të kujdesshëm nëse vendosni të merrni mjete financiare prej subjekteve prej vendeve të cilat formalisht janë identifikuar me rrezik të lartë për aktivitete terroriste, si dhe prej atyre të regjistruara në vendet që konsiderohen si parajsë tatimore (ku është e vështirë të përcaktohet burimi i pronarit të vërtetë të kompanisë). Për ta lehtësuar këtë rrezik, mund t'i referoheni Listës së FATF për jurisdikSIONET me rrezik të lartë dhe jurisdikSIONET nën **monitorim të përforsuar që është në dispozicion publikisht në** <<link>>



Shuma më të mëdha të donacioneve të cilat donatori i ofron me para të gatshme. Edhe pse donacionet me para janë të zakonshme për ngjarjet për grumbullimin e mjeteve financiare drejtpërdrejtë, jini të kujdesshëm nëse një donator qaset drejtpërdrejt dhe ju ofron donacion më të madh në të holla. Kur përcaktoni se çfarë është donacion i madh, shikoni praktikat e zakonshme në vendin tuaj lidhur me pagesat me para të gatshme, gjegjësisht se cila shumë për mall/shërbim do të konsiderohej e zakonshme që të paguhet me para të gatshme në vendin tuaj nga një njeri/kompani e dhënë?

Një individ nga një vend me rrezik të lartë dëshiron t'i transferojë donacion një OJF-je në Maqedoninë e Veriut. Për ta kontrolluar transaksionin, banka kërkon marrëveshje me donatorin që të transferohen paratë në xhiro-llogarinë e OJF-së. Meqë OJF nuk ka marrë donacion prej këtij personi, para se drejtpërdrejtë të kontaktojë me donatorin, e kontrollon qëllimin e donacionit dhe më pas vendosë se donacioni është i pranueshëm dhe nënshkruan marrëveshje.

Lista për verifikim

☐	Organizata juaj a bën kontroll paraprak që të sigurohet se i njeh donatorët e vet, veçanërisht për donacione më të mëdha (më të mëdha se atë që e fitoni zakonisht dhe gjithsesi për shuma mbi pagën mesatare në vend)?
☐	A mbani dokumentacion për donacionet e marra?

NJOFTOJENI SHFRYTËZUESIN APO KLIENTIN TUAJ

OJF sigurojnë shërbime të ndryshme, ndihmë humanitare por edhe mjete financiare për organizata dhe individë. Krijimi i masave dhe praktikave për ta njoftuar shfrytëzuesin tuaj do t'i mundësojë OJF-së tuaj të kujdeset ndihma e dhënë të arrijë deri tek shfrytëzuesi për të cilin është qëllimi dhe të mos keqpërdoret në çfarëdo mënyre.

OJF përdorin mënyra të ndryshme për t'i identifikuar shfrytëzuesit e tyre dhe shpesh lidhen me bashkësitë e tyre dhe i njohin nevojat e anëtarëve të tyre. Në procesin e zgjedhjes së shfrytëzuesve, OJF kanë qasje të drejtpërdrejtë tek shfrytëzuesit final (për shembull, organizata qytetare të cilat drejtpërdrejtë sigurojnë ndihmë personave të cenueshëm, përfshirë edhe ndihmë financiare) ose në mënyrë indirekte e shpërndajnë mbështetjen e tyre përmes palëve të treta (për shembull, fondacion i cili siguron grante për organizatën e cila u ndan bursa nxënësve/studentëve me mundësi të kufizuara).

Në të dyja rastet, OJF duhet ta reduktojë rrezikun nga keqpërdorimi në minimum me atë që do t'i njoftojë shfrytëzuesit e vet. Në rastin e parë, masat do të drejtohen drejt shfrytëzuesve final (për shembull kritere për zgjedhje, kontroll dhe verifikim nëse është e nevojshme etj.), në rastin e dytë, fondacioni do të kujdeset pranuesi i grantit të përmbushë një përmbledhje rregullash dhe kjo do të verifikohet (për shembull udhëzime për zgjedhjen e shfrytëzuesit të bursës, kërkesë për listën e shfrytëzuesve, kontroll rastësor të identitetit, sigurime se përdoren sisteme ndërkombëtare formale CAMELS për rangimin e institucioneve financiare kur bëhet fjalë për transaksione financiare tj.).

Parimi për ta njoftuar shfrytëzuesin tuaj mbase jo gjithmonë është i zbatueshëm. Për shembull, OJF që merret me mirëmbajtjen e një kopshti urban me kënd lojrash që është në dispozicion në një hapësirë publike nuk është në pozitë për t'i zgjedhur shfrytëzuesit e vet dhe nuk është as logjike t'i identifikojë dhe t'i verifikojë identitetet e shfrytëzuesve të tij.

Në përgjithësi, OJF-të duhet të marrin parasysh rreziqet që disa individë ose organizata mund të abuzojnë me mbështetjen e

ofruar duke bërë pretendime të rreme, duke përfshirë krijimin e përdoruesve që nuk ekzistojnë. OJF-të duhet të verifikojnë në mënyrë të arsyeshme që përfituesit e tyre janë të vërtetë dhe, nëse dyshojnë se ndihma e tyre po përdoret për aktivitete kriminale, ta raportojnë atë tek organet institucionale.

Fondacioni siguron grante për një OJF të vogël. OJF drejton një ndërmarrje sociale e cila punëson dhe blen produkte prej një numri të madh shfrytëzuesish. Projekti përfshin pagesë me para të gatshme, ndërsa OJF kërkon një transhe nga granti që të transferohet llogaria bankare e cila nuk është në emër të pranuesit të grantit. Fondacioni do të bëjë vizitë terrenore për monitorim, do ta kontrollojë dokumentacionin për shfrytëzuesit e projektit (shikoni në pjesën “Njoftojeni shfrytëzuesin tuaj”) dhe do të kërkojë shpjegim me shkrim pse paratë duhet të transferohen në llogari që nuk është pronë e OJF-së, pas çka do ta refuzojë opsionin.

Nëse nuk mund të merrni lehtësisht informacion për shfrytëzuesit tuaj për shkak të burimeve të kufizuara, madhësinë e grupeve të përdoruesve, etj., merrni parasysh përdorimin e vetëdeklarimit nga përdoruesi, dmth. përdoruesi për të konfirmuar që mbështetja që ai merr nga ju nuk do të përdoret për financim, aktivitete të lidhura me terrorizëm, sjellje korruptive ose akte të tjera kriminale. Nëse nënshkruani kontrata me klientët tuaj, ju mund të përfshini anëtarë të tillë në vetë kontratën.

Kur bëhet fjalë për shfrytëzues në vende të tjera, lëndë e një kujdesi të veçantë dhe kontrolli i dokumentacionit duhet të jenë

vendet me regjim të dobët për PPP/PFT. Për këtë qëllim, mund ta përdorni Listën e FATF të jurisdiksioneve me rrezik të lartë dhe jurisdiksioneve nën **monitorim të përforcuar që është publikisht në dispozicion në internet në <<linkun>>**

Lista për verifikim



Organizata juaj a kontrollon, atje ku është e mundur, se nuk mbështetë individë dhe/apo organizata lidhur me terrorizmin?

NJOFTOJENI SHFRYTËZUESIN/KLIENTIN TUAJ

Partneritetet janë me rëndësi thelbësore për OJF-të veçanërisht në Maqedoninë e Veriut. Ato mundësojnë ndikim më të gjerë social të OJF-të dhe janë veçanërisht të rëndësishme për qëndrueshmërinë financiare, duke u mundësuar organizatave të aplikojnë për mjete financiare dhe realizimin e përbashkët të programeve.

Në bazë të vlerësimit të rreziqeve, OJF duhet të vendosin se deri në ç'nivel do të ndërmerren hapa për kontrollin paraprak për partneritë e tyre dhe masat për parandalim të cilat do të zbatohen. Njohja e partnerit tuaj është veçanërisht i rëndësishëm nëse janë përfshirë transaksione financiare apo materiale midis jush dhe partnerit. Në shtojcë janë dhënë disa situata dhe shembuj të cilët paraqesin flamuj të kuq:



OJF ka për qëllim të aplikojë për grant dhe kërkon një organizatë partnere. Në të janë drejtuar disa organizata. Në procesin e përzgjedhjes, OJF i zbaton hapat vijues për kontroll paraprak: e verifikon identitetin e organizatës duke përdorur burime që janë në dispozicion publikisht (kontrolli i ueb faqes, përdorimi i shfletuesit në Regjistrin qendror); e verifikon imazhin e organizatave (kërkimin në internet, kërkimin e informacioneve prej OJF-ve të tjera të cilat paraprakisht kanë bashkëpunuar me organizatën etj.); komunikon drejtpërdrejtë me partnerët potencial duke e vlerësuar kapacitetin dhe motivin e tyre.



OJF bashkëpunon me një organizatë më të vogël nga një komunë tjetër për të cilën është përcaktuar rrezik i rritur prej një aktiviteti terrorist. Meqë OJF dëshiron ta mbështesë partnerin e vet lokal, ajo i lejon t'i shfrytëzojë hapësirat e veta dhe pajisjen kur duhet të punojnë në qytetin ku është selia e OJF-ve. Në këtë rast, OJF-ja juaj duhet të sigurohet se organizata partnere dhe njerëzit që e prezantojnë i përdorin subjektet tuaja vetëm si aktivitete legjitime të organizatës dhe jo si veprime kriminale potenciale siç janë një propagandë ekstremiste dhe ngjashëm.

Mekanizmat dhe masat për parandalim të cilat QJF-të mund t'i zbatojnë lidhur me partnerët e tyre potencialë dhe partnerët aktual përfshijnë:

☐	Sigurohuni se e njihni partnerin;
☐	Kontrollojeni reputacionin e partnerëve potencialë;
☐	Dakordoni partneritete me organizata të cilat kryejnë aktivitete në pajtim me misionin e tyre;
☐	Kur jeni në partneritet i cili përfshin transaksione financiare, nënshkruani marrëveshje formale me partnerët, të cilët i definojnë rolet dhe përgjegjësitë e të dyja palëve, e rregullojnë përdorimin e mjeteve, ndjekjen, shpenzimin dhe raportimin, mbikëqyrjen etj. Përfshini klauzola për PPP/PFT në marrëveshjet;
☐	Sigurohuni se partnerët punojnë në mënyrë ligjore, i shlyejnë obligimet tatimore dhe të kenë menaxhim të mirë financiar. Në procesin e verifikimit paraprak, shfrytëzoni listën e verifikimit të sanksioneve ndërkombëtare dhe vendore
☐	Ruani marrëdhëniet me partnerët duke i inkurajuar t'i shprehin të gjitha arsyet për brengosje dhe dilema të cilat i kanë.

Në linqet në vijim do të gjeni informacione lidhur me listën ndërkombëtare dhe vendore të

sanksioneve të cilat mund t'i përdorni në procesin e kontrollit paraprak:

Lista ndërkombëtare e sanksioneve



Burim i informacioneve për procedurat për dhënien e certifikatave që nuk janë të gjykuar dhe informacione prej dosieve kriminele nga organet gjyqësore



Procedurë për dhënien e informacioneve për shkelje, dënime dhe ndalesa nga Regjistri qendror



Lista për verifikim



Organizata e juaj e kontrollon besueshmërinë dhe përgjegjësinë e partnerëve të cilët i përfshini në projekte të përbashkëta, përfaqësim dhe nisma të tjera?

MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhim i fuqishëm financiar dhe kontroll të brendshëm gjithëpërfshirës është qasje që do t'i parandalojë mundësitë për keqpërdorim financiar dhe sjellje jopërkatese. OJQ duhet në mënyrë efikase t'i përdorë mjetet për përmbushjen e misionit të tyre dhe në pajtim me qëllimin e financimit. Procesi i përgatitjes së procedurave financiare në formë me shkrim duhet të ketë për qëllim t'i minimizojë rreziqet nga keqpërdorimi i mjeteve. Madje edhe nëse jeni organizatë e vogël, duhet të përpiqeni t'i dokumentoni procedurat dhe standardet kryesore për menaxhim me financat në organizatën tuaj. Në këtë pikëpmaje, merrni parasysh elementet vijuese të sistemit për menaxhim financiar të cilët do t'ju mundësojnë ta mbronin organizatën tuaj nga keqpërdorimi potencial i LP/FT:

Kontrolli i brendshëm i cili siguron përdorim të drejtë të mjeteve. Kujdesuni nivelet e ndryshme të organizatës të bëjnë rishikim periodik (të paktën njëherë në vit) në mënyrën në të cilën grumbulloni mjete dhe i shpenzoni resurset e organizatës. Kërkoni nga kontabilisti juaj të bëjë verifikim të dyfishtë të dokumenteve tuaja dhe të sigurohet se raportet e juaja të brendshme janë harmonizuar me evidencën e tij kontabiliste.

Dokumentacion financiar i cili është i qartë dhe i verifikueshëm lehtë

Evidencë për pranimin dhe realizimin e mjeteve duke e përfshirë qëllimin e tyre

Veçanërisht për organizatat më të mëdha, disa nivele të verifikimit dhe kontroll financiar: bazë të shpenzimeve, miratim dhe realizim (kontrolli dhe miratimi i shpenzimeve) – siç është dhënë në pjesën e menaxhimit të mirë, kontrolloni nëse së paku dy persona në organizatë janë përfshirë në procesin e transaksioneve financiare. Për organizatat e vogla, praktikë e mirë është, për shembull, një person ta plotësojë urdhëresën pagesore (çekun), ndërsa personi i autorizuar vetëm ta nënshkruajë.

Kontabiliteti në pajtim me obligimin ligjor (varësisht prej madhësisë së organizatës)

Revizione të brendshme dhe të jashtme (në pajtim me mundësitë e organizatës)

Përdorimi minimal i parave të gatshme

Përdorimi i transfertave formale financiare dhe shërbimeve

Kujdes i veçantë gjatë punës me vende të tjera. Ndiqni udhëzimet për kontrollin paraprak të donatorëve, shfrytëzuesve dhe partnerëve dhe dokumentoni drejtë.

Dokumentimi i donacioneve (dhënia e vërtetimeve për donacionin e marrë pas marrjes së tij, marrëveshje me klauzola për PPP/PFT ku është relevante, lista të donatorëve etj.)

Kontrolli ditor i transaksioneve financiare dhe identifikimi i transaksioneve të pazakonta

Verifikime të arsyeshme paraprake.

Për të mësuar më shumë për planifikimin financiar dhe donacionet në sektorin e OJF-së, shfrytëzoni drejtimet e Konekt të cilat mund t'i gjeni në këto linqe në gjuhën **maqedonase** dhe në gjuhën **shqipe**.



Lista për verifikim

☐	Organizata e juaj a mban evidencë të detajuar për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e organizatës dhe a sigurohet se janë në pajtim me punën e organizatës?
☐	Organizata e juaj a i publikon rregullisht programin vjetor dhe raportet financiare në mënyrë në të cilën është i qartë dhe siguron detaje të mjaftueshme për informimin e opinionit?
☐	Organizata e juaj a ka politika dhe procedura për kontroll të brendshëm financiar që të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie?

MENAXHIMI ME RESURSET NJERËZORE

Gjatë punësimit ose angazhimit të personelit (përfshirë vullnetarët), OJF-ja duhet të kryejë kontrollet paraprake bazë, gjegjësisht kontrolle mbi aktivitetet e kaluara. Puna me njerëz të besuar është thelbësore për të mbrojtur organizatën tuaj nga abuzimi i mundshëm. Praktikrat e mira të menaxhimit të burimeve njerëzore ofrojnë mbrojtje adekuate, por faktorët e rrezikut duhet të merren parasysh në Vlerësimin e rrezikut nga FT për OJF-të (infiltrimi i eksponentit të një ideologjie radikale).

SHEMBULL PËR FLAMUR TË KUQ

Një bashkëpunëtor kërkon shërbim nga OJF e vogël. Një shtetas i njohur i huaj i cili jeton në qytet duhet të sigurojë status ligjor për leje për qëndrimin e bashkshortes së tij. Nga OJF kërkohet të nënshkruajë marrëveshje për punë vullnetare me të cilën do të zgjidhet situata. OJF refuzon, pasi në praktikë nuk do të vijë drejt punës vullnetare reale që paraqet shkelje të ligjit. Më tej, vullnetarët e OJF kanë të drejtë të kufizuar për të vepruar në emër të organizatës.

Edhe pse është ireale të pritet OJF të zbatojnë kontrolle të detajuara për aktivitetet e kaluara, disa prej masave për lehtësim të cilat mund t'i zbatoni përfshijnë:

☐	Kontrolli i aktiviteteve të kaluara të personelit ose vullnetarëve potencial (kontrolli i rekomandimeve, të punësuarve paraprakë etj.)
☐	Kontrolli i listave ndërkombëtare dhe vendore të sanksioneve
☐	Krijimi i mekanizmit përmes të cilit personeli do të mund të paraqesë ose të shprehë shqetësim
☐	Shfrytëzimi i formularëve me shkrim/deklaratave për persona të angazhuar, të punësuar dhe vullnetarë me të cilët do të deklarohen se nuk janë të përfshirë në terrorizëm dhe financimin e terrorizmit
☐	Ndërtimi i kulturës së integritetit, zhvillimit apo pjesëmarrje në Kodet ekzistuese të sjelljes

Për të mësuar më shumë për organizimin e punës vullnetare të OJF-ve, shfrytëzoni udhëzimet e Kontekt të cilat mund t'i gjeni në këto linqe në gjuhën **maqedonase** dhe **shqipe**.

TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE

Transparenca dhe llogaridhënia janë shtylla kryesore të shoqërisë qytetare. Informacionet që janë në dispozicion publikisht për OJF kanë përfitime më shumështresore dhe ndërtojnë besim në OJF tek themeluesit e tyre, shfrytëzuesit, donatorët dhe bashkësitë.

Duke e pasur parasysh PPP/PFT, një prej faktorëve të rrezikut të përcaktuar në Vlerësimin e rreziqeve nga FT për OJF është kur OJF nuk japin informacione për aktivitetet e tyre dhe transaksione të kryera financiare në mënyrë në të cilën institucionet mund të bëjnë verifikimin. Ta keni parasysh se burimet publike siç janë ueb faqet e OJF, platformat për mediat sociale, janë burim i rëndësishëm i cili është me rëndësi thelbësore për punën e të gjitha institucioneve të cilat e përbëjnë sistemin për mbrojtjen e FT/PPP, prandaj sigurohuni se OJF ta ruajë transparencën dhe llogaridhënien e vet.

Që të harmonizoheni me obligimin ligjor dhe praktikën e mirë, verifikoni nëse këto në vijim janë në dispozicion:

Raporte financiare vjetore (raporte). Sigurohuni që raportet tuaja të japin informacione që kuptohen lehtë dhe që janë gjithëpërfshirëse për burimet tuaja të financimit, si edhe për qëllimin dhe shfrytëzimin e mjeteve të organizatës.

- Raporte vjetore narrative
- Informacione të sakta për anëtarët e organeve tua-ja drejtuese, menaxhuese dhe të punësuarit (emra, mbiemra dhe biografi)
- Dokumente statutore
- Informacione lidhur me vizionin, misionin, qëllimet dhe aktivitetet vijuese
- Lista të donatorëve dhe burime të financimit (në disa raste kur miratohet nga donatori)
- Informacione për kontakt të drejtpërdrejtë

Përveç kësaj, lidhur me PPP/PFT, OJF mund të vendosë të publikojë informacione (për shembull në ueb faqe) se zbaton kontroll paraprak të donatorëve, shfrytëzuesve dhe partnerëve. Kjo gjithashtu vepron si mekanizëm parandalues i cili i demotivon ata të cilët dëshirojnë ta keqpërdorin organizatën.

Për të mësuar për obligimet për transparencë dhe llogaridhënie për OJF-të, shfrytëzoni drejtimet e Konekt të cilat mund t'i gjeni në linqet në gjuhën **maqedonase** dhe në gjuhën **shqipe**.

Lista për verifikim



Organizata a i publikon rregullisht raportet vjetore narrative dhe financiare, si edhe informacionet e tjera relevante në mënyrë e cila është e qartë dhe siguron detaje të mjaftueshme për ta informuar opinionin?



VETËRREGULLIMI

Vetërregullimi është një mënyrë efektive që OJF-të të vendosin standarde të larta të rregullimit “të butë” dhe të përpiqen për praktikat më të mira. Mekanizmat vetërregullues në Maqedoninë e Veriut po bëhen gjithnjë e më të njohur në sektorin e OJF-ve. Këshillohet që t’i bashkoheni një nisme si Kodi i Sjelljes për organizatat qytetare, vetërregullimi për organizatat që ofrojnë shërbime, “Marka e besimit” etj.

“Marka e besimit” është një mekanizëm vetërregullues që synon të lehtësojë aksesin e qytetarëve dhe kompanive në organizatat e besuara për të cilat ata mund të bëjnë donacione. Qëllimi i tij është të forcojë besimin afatgjatë ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe donatorëve lokalë. Për qëllime të PPP/PFT, “Marka e besimit” u ngrit mbi kriteret në përputhje me standardet e FATF. Metodologjia është zhvilluar nga Qendra Evropiane për të Drejta Jofitimprurëse – ECNL dhe Konekt duke shqyrtuar modele të ngjashme në një numër vendesh dhe duke e lokalizuar mekanizmin në kontekstin e Maqedonisë së Veriut. Për të fituar “Markën e besimit”, OSHC-të duhet t’u përmbahen disa parimeve dhe kriterëve të vendosura në lidhje me fushat e mëposhtme:

- Misioni dhe vlerat
- Qeverisja demokratike dhe e mirë
- Menaxhimi financiar
- Transparenca dhe llogaridhënia

Komunikimi dhe përfaqësimi

Grumbullimi i mjeteve

Resurse njerëzore

Për të marrë “Markën e besimit”, si hap i parë, organizatat e shoqërisë civile zbatojnë vetëvlerësime. Më pas, Këshilli i “Markës së besimit” e verifikon dokumentacionin e siguruar shoqërues dhe organizon takime shtesë me OSHC. Në fund të këtij procesi, Këshilli, i cili përbëhet nga ekspertë prej më shumë fushave, përcakton nëse OSHC do ta marrë Markën e besimit.

HAPA 4

Siguroni zbatim të vazhdueshëm

Pasi t’i përcaktoni masat për zbutje në bazë të rreziqeve të vlerësuara dhe do t’i integroni në mënyrë përkatëse në statutet, politikat dhe procedurat e organizatës, është e rëndësishme vazhdimisht t’i zbatoni përmes programeve dhe strukturave të organizatës. Informoni personat përgjegjës, trupat drejtues dhe personelin e organizatës për rreziqet e identifikuara dhe sigurojuni mbështetje në zbatimin e masave.

Si pjesë e zbatimit të masave për zbutje, është e rëndësishme organizata t’i përcaktojë procedurat në raste kur do të vërehet ndonjë aktivitet i dyshimtë lidhur me punën e saj. Për shembull, përpiquni të mendoni në politikat e juaja për pyetjet vijuese: Çfarë duhet të bëjë një anëtar i personelit nëse dyshon se një anëtar tjetër i personelit ose shfrytëzues i keqpërdor mjetet e organizatës siç

janë LP ose FT? Çfarë nëse një anëtar i Kuvendit është i shqetësuar lidhur me ndonjë anëtar të ri për të cilin dyshon se është i lidhur me grupe ekstremiste? Çfarë hapash duhet të ndërmerren menjëherë financiar, nëse dyshon në origjinën e donacionit nga një donator i caktuar?

Lista për verifikim



Organizata juaj a ka vendosur politika që të sigurojë zbatimin e masave lehtësuese, përfshirë edhe kur ekziston dyshimi për një aktivitet të dyshimtë?

HAPA 5

Bëni shqyrtime periodike dhe përshtatuni

Përfundimisht, sikurse edhe çdo proces strategjik dhe proces i planifikimit, kujdesuni që organizata juaj kohë pas kohe t'i kontrollojë rriziqet e vlerësuara dhe efektivitetin e masave lehtësuese. Kjo mund të bëjë çdo dy vjet ku ekipi juaj kryesor do t'i shqyrtojë të gjitha ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm të vendit (niveli i rrezikut nga terrorizmi, nivelet e korrupsionit dhe krimet etj.); ndryshime në programe dhe fokusi i organizatës, llojet e shfrytëzuesve etj. Verifikoni nëse rriziqet e njëjta janë akoma prioritet për organizatën dhe nëse nuk janë, në mënyrë përkatëse përshtatni vlerësimin e rrezikut. Shqyrtojeni efektivitetin e masave lehtësuese dhe përshtatni politikat dhe procedurat sipas nevojës.

VI. ANEKSE


ANEKSI 1

PROCESI I VLERËSIMIT TË NDËRSJELLË

Në vitin 2014, FATF vendosi metodologji të re për vlerësim e cila përfshin komponentë për efektivitetin me të cilin shqyrtohet zbatimi i standardeve jashtë vetë harmonizimit teknik (vetëm ligje dhe rregullativa). Përveç verifikimit nëse ligjet dhe rregullativat i përmbushin standardet e FATF, vlerësuesit fokusohen në ndikimin e çfarëdo masave ekzistuese për PPP/PFT, duke pyetur nëse ato vërtetë janë efektive në terren. Vëllimi i vlerësimit i përfshin vetëm dy komponentë të lidhura midis tyre:

Komponenti për harmonizim teknik do të vlerësojë nëse ligjet e nevojshme, rregullativat ose masat e tjera të nevojshme janë në fuqi, dhe nëse është vendosur kornizë institucionale për mbështetjen e PPP/PFT.

Komponenti për efektivitet do të vlerësojë nëse funksionojnë sistemet për PPP/PFT dhe shkalla deri në cilën vendi e arrin paketën e përcaktuar të rezultateve. Efektiviteti përcaktohet në bazë të 11 rezultateve të drejtpërdrejta (RD) për verifikimin e efektivitetit. Ekzistojnë 11 RD të cilat mund të vlerësohen me nivel të ulët, nivel të mesëm, nivel të konsiderueshëm dhe nivel të lartë të efektivitetit. Rezultati i drejtpërdrejtë i cili ka të bëjë me OJF është RD 10, për masat e parandalimit dhe sanksioneve financiare lidhur me FT.



Burimi: ueb – faqja e FATF

I gjithë procesi i vlerësimit zakonisht zgjat mbi një vit dhe përbëhet prej disa hapave, të cilat në mënyrë rigoroze mund të ndahen në tri faza:

1

Përgatitje për vizitën e vlerësuesit në vend (vizita në vendngjarje), me ç'rast formohet një ekip për vlerësim, ndahen materiale përgatitore dhe fillon verifikimi i harmonizimit teknik të ligjeve dhe rregullativave (hulumtim desktop);


2

Vizitë në vendngjarje e ekipit të vlerësuesit në vend gjatë së cilit vlerësuesit takohen dhe diskutojnë për efektivitetin e sistemit për PPP/PFT me përfaqësues qeveritarë, institucione dhe përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, përfshirë edhe OJF-të;

3

Periudha pas vizitës në vendin e ngjarjes, gjatë kohës në të cilën vlerësuesit përgatisin Raport për vlerësim të ndërsjellë (RVN), diskutojnë dhe i zhvillojnë informacionet hyrëse dhe komentet nga vendi dhe Sekretariati për FATF. Në fund, raporti miratohet dhe publikohet.


The Procesi i vlerësimit të ndërsjellë



Burimi: ueb – faqja e FATF

Pas miratimit dhe publikimit të RVN, vendi mund të vendoset në procedurë të rregullt ose të përforcuar për ndjekje, varësisht vlerësimit të përgjithshëm të saj dhe harmonizimit me standardet e FATF. FATF dhe organet rajonale në stilin e FATF sjellin raporte për ndjekje ku mund të ndiqet progresi i çdo vendi, përfshirë edhe standardet për OJF. Procedura për ndjekje dedikohet për nxitjen

e vazhdueshme dhe vlerësimin e progresit të cilin vendi e arrin në zbatimin e standardeve për PPP/PFT. Si rezultat i kësaj, cikli i vlerësimit në praktikë nuk ndalon asnjëherë.³⁹



Burimi: ueb – faqja e FATF

Sa i takon besueshmërisë së procesit, zakonisht, të gjitha dokumentet, komentet dhe informacionet e prodhuara gjatë procesit të vlerësimit, përveç raportit të publikuar, trajtohen si të besueshme. Kjo bën të bëhet shumë rëndë, nëse jo edhe e pamundshme, palët e treta (siç është sektori i OJF) të kenë kontribut formal dhe të rëndësishëm në proces.

Gjatë procesit, Sekretariati për FATF/Organet rregullatore në stilin e FATF kanë rol të theksuar:

39 Për më shumë informacione shkoni në: <https://www.fatf-gafi.org/publications/mutualevaluations/documents/universal-procedures.html>

- I japin mbështetje ekipit për vlerësim dhe vendin e vlerësuar;
- Fokusohen në cilësinë dhe vazhdimësinë;
- Sigurojnë harmonizim me procesin dhe procedurat;
- U ndihmojnë vlerësuesve dhe vendit të vlerësuar gjatë interpretimit të standardeve, metodologjisë dhe procesin në pajtim me Vendimet plenare paraprahe;
- Sigurohen se vlerësuesit dhe vendet e vlerësuar kanë qasje në dokumentacionin relevant; e udhëheqë procesin dhe detyrat e tjera siç është dhënë në këto procedura.

Duke e pasur parasysh rolin gjithëpërfshirës të Sekretariatit dhe besueshmërisë të të gjithë procesit, pikë bashkëpunimi gjatë procesit të shoqërisë civile duhet të jetë Sekretariati i FATF/Organet rajonale në stilin e FATF.⁴⁰

Shënimet tuaja:

40 Më shumë informacione për procesin e ndjekjes dhe rolit të FATF/Trupar rajonal në stilin e FATF në këtë publikim: <https://ecnl.org/publications/how-can-civil-society-effectively-engage-counter-terrorism-processes>

ANEKSI 2

ANGAZHIMI I FATF ME SEKTORIN E OJF-SË

FATF siguron drejtime të shumëfishta për qasjen dhe angazhimin me sektorin e OJF-së. Për shembull:


Vendet vlerësohen në bazë të asaj nëse dhe si mund të prekin dhe t'i konsultojnë palët e involvuara private në politikat, ligjet dhe vlerësimet e rrezikut (Rekomandimi 1 i FATF dhe Rezultati i drejtpërdrejt 1);

Vendet duhet të bashkëpunojnë me OJF për t'i përgatitur dhe t'i zhvillojnë praktikatat më të mira për t'u përballur me rrezikun dhe cenueshmërinë nga financimi i terrorizmit dhe në këtë mënyrë të mbrohen nga keqpërdorimi i qëllimeve të financimit të terrorizmit (Metodologjia e FATF, Rekomandimi 8.2 (v)); Qasja participuese ndaj vlersimeve të rrezikut është praktika më e mirë (Udhëzim për vlerësimin e rrezikut nga financimi i terrorizmit të FATF, faqe 68).

FATF para ca kohësh e njohu rëndësinë vitale të OJF në sigurimin e shërbimeve kryesore të bamirësisë në mbarë botën si edhe vështirësitë gjatë sigurimit të kësaj ndihmë për ata që u nevojitet. FATF i inkurajon vendet të punojnë me OJF-të relevante që të sigurohen se ndihma e nevojshme në mënyrë transparente arrin deri tek pranuesit e dedikuar. (Deklaratë e FATF 2020 për sektorin e OJF dhe Kovid-19).

Inkurajohet edhe angazhimi i qëndrueshëm i komunitit me sektorin e OJF-së në kuadër të Dokumentit me praktika më të mira të FATF për luftë kundër keqpërdorimit të organizatave jofitimprurëse (Rekomandimi 8).⁴¹

Përfshirja e sektorit OJF duhet të jetë aktivitet i vazhdueshëm dhe të bazohet në nivele të ndryshme të përfshirjes, ndërgjegjësimit dhe arsimit, deri në dialogun afatgjatë dhe bashkëpunimin.



Burimi: ueb – faqja e Koalicionit global të OJF-ve

41 Për më shumë informacione shkoni në: <https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/BPP-combating-abuse-non-profit-organisations.pdf>

Ngritja e vetëdijes për çështje lidhur me PFT për sektorin e OJF-së

Si pjesë e angazhimeve më të gjera për zbutjen e rreziqeve nga financimi i terrorizmit, ngritjen e vetëdijes dhe sigurimin e informacioneve të sakta për sektorin e OJF-së paraqet hap të parë kryesor. Kjo përfshin publikimin e informacioneve, këshillave, burimeve si edhe tipologjive të keqpërdorimit potencial për FT dhe si të njihen. Kjo nënkupton edhe organizimin e takimeve të përbashkëta, diskutimeve dhe dialogut për njoftim me perceptimet dhe shqetësimet e OJF dhe për informimin e drejtpërdrejtë të tyre për çështjet. Vendet mund të publikojnë material dhe informacione për ngritjen e vetëdijes në internet që të sigurojnë qasje të lehtë dhe të hapin linja të drejtpërdrejta komunikimi për disa arsye të caktuara për shqetësim dhe pyetje.

Zhvillimi dhe siguri i materialeve edukative për sektorin e OJF-së

Disa vende kanë zhvilluar dhe publikuar materiale dhe udhëzime edukative, në konsultim me OJF-të, mbi një sërë temash që ndihmojnë sektorin e OJF-ve të kuptojë dhe të zbusë rreziqet e veta. Temat mund të përfshijnë rekomandime për praktikatat më të mira në zbutjen e rrezikut, udhëzimet për qeverisjen e mirë dhe menaxhimin financiar, mbrojtjen nga mashtrimet dhe abuzimet, ndarjen e shembujve praktikë dhe mund të përfshijnë gjithashtu zhvillimin e një pakete mjetesh në internet për OJF-të. Ka shumë të tilla në sektorin e OJF-ve si vetërregullimi, kodet e sjelljes dhe të ngjashme. Prandaj, komunikimi me OJF-të dhe interesimi për

mekanizmat ekzistues vetërregullues, standardet e brendshme dhe kodet e sjelljes mund të ndihmojnë në përpjekjet për të krijuar udhëzime dhe materiale edukative.

Angazhim në komunikimin e qëndrueshëm dhe dialogun (me më shumë palë të involvuara) me sektorin e OJF-ve

Dialogu i qëndrueshëm është mënyra më e mirë që të kuptohen çështjet e ndryshme lidhur me zbutjen e rrezikut (sigurinë, zhvillimin parimet humanitare, integritetin financiar, rregullativën) dhe për angazhimin efektiv me sektorin për aspekte konkrete. Me rëndësi kryesore është vendet, veçanërisht organet rregullatore, të luajnë rol konsekuent dhe të angazhuar në forumet me më shumë palë të involvuara që të sigurohet se dialogu është i vazhdushëm dhe i institucionalizuar si dhe se rezultatet janë të qëndrueshme. Duhet të bëhen angazhime që të identifikohen dhe angazhohen OJF më të vogla të cilat mund të përballen me sfidat ose të kërkojnë përgjigje ose mbështetje të ndryshme. Që të sigurohet se dialogu do të shndërrohet në praktikë, duhet të ketë resurse të përkushtuara dhe mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve të qeverisë, OJF-së dhe sektorit privat për zgjidhjen e çështjeve të përcaktuara.


*Shembuj për praktika të mira:*⁴²

Në Kirgizi dhe Kosovë: janë vendosur marrëdhënie të mira pune midis përfaqësuesve të OJF-ve dhe përfaqësuesve qeveritarë, ndërsa zhvillohet edhe dialog i vazhdueshëm dhe angazhim për çështjet lidhur me PPP/PFT.

Holandë: Është formalizuar proces i tryezës së rumbullakët që mbulon Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë dhe Sigurisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, Drejtorinë e Zbulimit Financiar, OJF-të - ombrellë/organizatat anëtare, si dhe organizata individuale, rregullatorin për mbledhjen e fondeve të OJF-ve, Asociacionin bankar dhe bankat ndërkombëtare për të trajtuar çështjet që lidhen me aksesin në financa me të cilat përballen OJF-të si rezultat i rregulloreve të PPP/PFT. Këtë tryezë të rumbullakët e thërret dhe drejton Ministria e Financave së bashku me një OJF të njohur me rregulloret e PPP/PFT dhe kuadrin më të gjerë të PFT. U hartua një dokument marrëveshjeje, i përpiqur nga OJF-të, Asociacioni holandez i Bankave dhe ministritë e përfshira, në të cilin janë dhënë elaborimi për tryezën, përgjegjësinë e secilit prej palëve të interesuara për të kontribuar në dialog dhe qëllimet e dialogut. Ky lloj modaliteti është kusht për legjitimitetin dhe qëndrueshmërinë e dialogut me shumë palë, pasi axhenda udhëhiqet nga shqetësimet dhe praktikatat e OJF-ve, PPP/PFT dhe analizat e politikave që lidhen me sanksionet e OJF-ve dhe agjencive qeveritare, si dhe si politikatat dhe praktikatat e bankave në lidhje me kontrollin paraprak të tyre ndaj

42 Shembujt bazohen në material intern të zhvilluar nga ECNL dhe nga Koalicioni global i OJF për FATF

klientëve. Rezultatet e takimeve të tryezës po qarkullojnë mes të gjithë pjesëmarrësve, por ende nuk janë shpallur. Ministritë, OJF-të dhe Asociacioni Hollandez i Bankave parashikojnë një sërë procesesh dialogu me aktorë më të vegjël që do të trajtojnë çështje specifike për nëngrupet e OJF-ve, së bashku me një dialog gjithëpërfshirës që mbahet një ose dy herë në vit. Diskutimi shtesë ka të bëjë me mundësinë që tryeza e rrumbullakët të jetë e hapur për publikun përmes një platforme/ueb-faqeje të caktuar. Nga diskutimet në tryezë rezultuan disa studime për shmangien e rrezikut të OJF-ve nga perspektiva e biznesit dhe të drejtave të njeriut të zbatuar nga fakulteti juridik në koordinim me bankën, OJF dhe një firmë avoaktie, e ila është e dedikuar për publikun më të gjerë bankar. Nga tryeza e rrumbullakët dolën disa zgjidhje të caktuara për përballim me çështjen lidhur me shmangien e rrezikut nga OJF, siç është portal për lehtësim dhe pranimin e OJF nga bankat.



ANEKSI 3

ANGAZHIMI NË PROCESIN E VLERËSIMIT TË RREZIKUT: SHEMBUJ PËR PRAKTIKA TË MIRA:⁴³

Mbretëria e Bashkuar: Vlerësimi nacional i rrezikut nga viti 2017

siguroi mundësi për konsultime të zgjeruara me OJF, duke përfshirë edhe një kontribut të caktuar, ndërsa e vlerësoi rrezikun nga keqpërdorimi i organizatave jofitimprurëse për financimin e terrorizmit si të "ulët". Ajo, gjithashtu i identifikoi edhe çështjen dhe ndikimin e shmangies së rrezikut nga bankat lidhur me organizatat bamirëse.⁴⁴

Tunizia: Institucionet shtetërore (përfshirë DZF-në, Drejtorinë e Përgjithshme për Shoqatat dhe Partitë Politike nën Presidencën e Qeverisë, Komisionin e Antiterrorizmit) dhe OJF-të lokale punuan në mënyrë efektive për të përditësuar Vlerësimin e rrezikut në sektor duke përdorur një metodologji të ofruar nga një anëtar i Koalicionit global. Bashkëpunimi dhe puna e bërë në zbatimin e P.8 në një mënyrë që mbron liritë e shoqërisë civile në tërësi u prit mirë, duke bërë që Tunizia të vlerësohej si e Harmonizuar me P.8 në vitin 2019 - një nga gjashtë vendet globalisht që morën një vlerësim të tillë . Po aq e rëndësishme, tani ekziston

43 Shembujt të bazohen në një material intern të zhvilluar nga ECNL dhe nga Koalicioni global i OJF për FATF.

44 Shiko më shumë këtu: https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/655198/National_risk_assessment_of_money_laundering_and_terrorist_financing_2017_pdf_web.pdf#2017

një partneritet i vërtetë midis qeverisë dhe shoqërisë civile për çështjet që lidhen me rreziqet e mundshme të FT në sektorin e OJF-ve dhe masat që duhen zbatuar për të zbutur këto rreziqe. FATF, ka hequr gjithashtu Tunizinë nga lista e “juridiksioneve me rrezik të lartë dhe juridiksioneve të mbikëqyrura”.

Në Maqedoninë e Veriut, qeveria dhe sektori i OJF-së kanë zbatuar aktivitete të përbashkët për vlerësimin e rrezikut, ndërsa më pas kanë vazhduar me dialog të qëndrueshëm për zhvillimin e masave lehtësuese, për çështje lidhur me përjashtimin financiar së bashku me sektorin bankar dhe për aktivitete të mëtejme komplementare për afrim deri tek ato organizata të cilat janë të ekspozuara në rrezik nga keqpërdorimi. Palët e involvuara u pajtuan se kur masat zhvillohen në kuadër të partneritetit, efikasiteti i tyre rritet. Për shembull, institucionet, bankat dhe OJF bashkërisht punojnë në rishikimin e indikatorëve për raportim për transaksione të dyshimta në sektorin e OJF-së. Pritet ky proces të mundësojë përmbledhjen e indikatorëve të cilët më lehtë do të implementohen në praktikë dhe do ta parandalojnë shmangien e rrezikut lidhur me sektorin e OJF-së.

Nigeri: Nigeria publikoi **Vlerësimin nacional të rrezikut** për FT dhe PP (të mbaruar në vitin 2016), i cili i identifikoi bizneset dhe institucionet e emëruara jofinanciare (BIJF), në të cilat si nën-grup bëjnë pjesë edhe OJF, si një prej sektorëve të cilët janë më të cenueshëm ndaj PP/FT. Organizata jofitimprurëse Spaces for Change, anëtare e Koalicionit global të OJF-ve, e **vuri në pikëpyetje** (2019) këtë vlerësim të rrezikut për sektorin jofitimprurës, me ç’rast, midis tjerash, e kontestoi klasifikimin zyrtar të OJF si pjesë e bizneseve dhe institucioneve të emëruara jofinanciare (BIJF) dhe i veçoi nuancat midis cenimit dhe kanos-

jes. Raporti çoi drejt angazhimit të rritur dhe konstruktiv me DZF (SCUML- Njësit special kontrollues kundër pastrimit të parave) dhe aktorëve të tjerë qeveritarë dhe aktorë nga sektori i OJF-së, përfshirë edhe Grupin ndërkombëtar aksional kundër pastrimit të parave në Afrikën Perëndimore (GIABA) si trup rajonal në sitlin e FATF për Afrikën Perëndimore.⁴⁵

Gjermania: Si përgatitje për vlerësimin e vendit, një rrjet gjerman jofitimprurës kreu një anketë brenda sektorit të OJF-ve në vitin 2019 për të zbuluar se si e vlerësojnë rrezikun e financimit të terrorizmit dhe çfarë masash marrin për ta minimizuar atë. Raporti analizoi rezultatet, kuadrin ligjor aktual dhe masat vetërregulluese të OJF-së dhe dha rekomandime për ndërgjegjësimin e OJF-së për këtë çështje. Ai gjithashtu shërbeu si një katalizator për angazhim të mëtejshëm midis të gjitha palëve të interesuara. Qeveria përfshiu gjetjet dhe rekomandimet e raportit të OJF-ve në vlerësimin e tyre zyrtar të rrezikut për vitin 2020.⁴⁶

45 Shiko më shumë këtu: <https://spacesforchange.org/unpacking-the-official-construction-of-risks-and-vulnerabilities-for-the-third-sector-in-nigeria/>

46 Shiko më shumë këtu: <https://ecnl.org/news/how-can-civil-society-meaningfully-contribute-discussions-preventing-terrorist-financing-npo>

VIII.

UDHËZIME

Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të parave (2019), Udhëzimi për parandalimin e financimit të terrorizmit për organizata bamirësie dhe jofitimprurëse [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://caipo.gov.bb>

APG, trupa rajonale në stilin e FATF (FSRBS) [onlajn]. **Në dispozicion në:** <http://www.apgml.org>

Shoqata Konekt (2021), Informacione për OSHC për regjistrimin e pronarit të vërtetë [onlajn]. **Në dispozicion në:** <http://konekt.org.mk>

Shoqata Konekt, Publikime [onlajn]. **Në dispozicion në:** <http://konekt.org.mk>

Regjistri qendror i Maqedonisë së Veriut (2020), Përshkrimi i procedurës, parakushte dhe kushte për përdorim [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.crm.com.mk>

Regjistri qendror i Maqedonisë së Veriut, Informacion për ekzistimin e një vendimi gjyqësor në Regjistrin e personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është shqiptuar sanksion ndalesë e kryerjes së profesionit, veprimtari apo detyra dhe ndalesë të përkohshme për kryerjen e ndonjë veprimtarie të caktuar [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.crm.com.mk>

Komisioni për organizata bamirësie të Anglisë dhe Uellsit (2010), Udhëzim për organizatat bamirëse dhe menaxhimi me rrezikun (CC26) [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.gov.uk>

Komisioni për organizata bamirësie të Anglisë dhe Uellsit (2011), Vegla për harmonizim: Mbrojtja e organizatave për bamirësi nga shkaktimi i dëmit Kapitulli 2: Verifikimi paraprak, ndjekja dhe përsëritja e përdorimit final të fondeve për bamirësi: rezyme [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://assets.publishing.service.gov.uk>

Komisioni për organizata bamirësie të Anglisë dhe Uellsit (2016), Vegla për harmonizim: Mbrojtja e organizatave për bamirësi nga shkaktimi i dëmit Kapitulli 2: Verifikimi paraprak, ndjekja dhe përsëritja e përdorimit final të fondeve për bamirësi [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://assets.publishing.service.gov.uk>

Këshilli i Evropës, Moneyval [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.coe.int>

Portali gjyqësor i Maqedonisë së Veriut [onlajn]. **Në dispozicion në:** <http://sud.mk>

ECNL (2016), Një sërë suksesesh në ndryshimin e politikave globale për luftë kundër terrorizmit të cilët ndikojnë në hapësirën qytetare [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ecnl.org>

ECNL (2017), ECNL dhe partnerët e koalicionit global të OJF ofruan vende për forumin konsultativ privat të FATF [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ecnl.org>

ECNL (2018), Si mundet shoqëria qytetare në mënyrë efektive të kycet në proceset për luftë kundër terrorizmit? [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ecnl.org>

ECNL (2020), Si mundet shoqëria civile në mënyrë të rëndësishme të kontribuojë në diskutimet për parandalimin e financimit të terrorizmit në sektorine OJF-së: Një shembull nga Gjermania [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ecnl.org>

ECNL (2021), Ndikimi i masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit mbi organizatat jofitimprurëse në rajonin e Partneritetit lindor [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ecnl.org>

Eur-Lex (2012), Karta për të drejtat themelore të Bashkimit Evropian [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://eur-lex.europa.eu>

Komisioni Evropian, Parandalimi i pastrimit të parave dhe parandalimi i financimit të terrorizmit [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ec.europa.eu>

FATF (2012-2021), Standarde ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe përhapjes [onlajn]. Në dispozicion në: <https://www.fatf-gafi.org>

FATF (2013), Metodologjia për vlerësimin e harmonizimit teknik me rekomandimet e FATF dhe efektivitetin e sistemeve për PPP/PFT [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF (2014), Rreziku nga keqpërdorimi terrorist në organizatat jofitimprurëse [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF (2015), Praktikat më të mira për luftë kundër keqpërdorimit të organizatave jofitimprurëse (Rekomandimi 8) [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF (2019), Udhëzim për vlerësimin e rrezikut nga financimi i terrorizmit [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF (2020), Metodologjia e FATF për vlerësimin e harmonizimit të rekomandimeve të FATF dhe efektivitetin e sistemeve për PPP/PFT [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF (2021), Procese të konsoliduara dhe procedura për vlerësime të ndërsjella dhe veprimi i mëtejshëm „Procedura universale” [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF (2021), Standardet ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe përhapjes [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF, Fjalor nga rekomandimet e FATF [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org/glossary>

FATF, Pastrimi i parave [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF, Vlerësime të ndërsjella [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

FATF, Rekomandime [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.fatf-gafi.org>

DZF e Maqedonisë së Veriut, Lista të masave restriktive [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>

DZF e Maqedonisë së Veriut (2018), Instruksione për mënyrën e identifikimit të pronarit të vërtetë [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>

DZF e Maqedonisë së Veriut (2020), Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 317/220; 275/19; 120/18 [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>

DZF e Maqedonisë së Veriut (2021), Raport për vlerësimin e zbatuar të rrezikut nga financimi i terrorizmit për organizatat jofitimprurëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>

DZF e Maqedonisë së Veriut, Pyetje që janë parashtruar më shpesh [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>

Qeveria e Maqedonisë së Veriut (2020), Ekspozimi i sektorit jofitimprurës për financimin e terrorizmit [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>

- Ministria e Financave e MB (2017), Vlerësimi nacional i rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit 2017 [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://assets.publishing.service.gov.uk>
- Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 317/220; 275/19; 120/18
- Ministria e Financave e Maqedonisë së Veriut (2005), Broshura e Drejtorisë për parandalimin e parave [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>
- Ministria e Financave e Maqedonisë së Veriut (2010), Doracak për zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit nga subjektet [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://ufr.gov.mk>
- Spaces for change (2019), Shpjegimi i konstruksionit zyrtar të rrezeqeve dhe cenimeve për sektorin e tretë në Nigeri [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://spacesforchange.org>
- UNODC, Seria e moduleve universitare për luftë kundër terrorizmit, Moduli 4 Përgjigje të drejtësisë penale të terrorizmit [onlajn]. **Në dispozicion në:** <https://www.unodc.org>

